Fenomeni i fëmijëve në lëvizje në syrin e fëmijëve

BASHKË PËR KUJDESIN TËRËSOR TË FËMIJËVE
BKTF

mario

Protect children on the move

FENOMENI I FËMIJËVE NË LËVIZJE NË SYRIN E FËMIJËVE

(Vlerësim Cilësor)

Shkurt 2012

Botim i Koalicionit
“Bashkë për kujdesin Tërësor të Fëmijëve”
në kuadër të zbatimit të projektit MARIO

Përgatitën: Alba Jasini dhe Sabina Tahsimi
Grupi i punës: Enkelejda Lopari dhe Sabina Çarcani

Design & Layout: Blendi Graceni

© E Drejtat e Autorit: Koalicioni BKTF
Ky raport nuk mund të shitet apo përdoret për qëllime përfitimi.

FALENDERIMET

Raporti « Fenomeni i fëmijëve në lëvizje në syrin e fëmijëve» është një iniciativë në kuadër të projektit Mario. Ky vlerësim synon të eksplorojë fenomenin e lëvizjes së fëmijëve, perceptimet, ndjenjat dhe mendimet e vetë fëmijëve që ndodhen në këtë situatë.

Koalicioni BKTF (Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve) dhe në veçanti, organizatat Terre des hommes dhe Save the Children në Shqipëri, dëshirojnë të falenderojnë dy autoret, Alba Jasini dhe Sabina Tahsimi, për proçesin e vlerësimit, konsultimit të vazhdueshëm, hartimin e metodologjisë dhe analizën e të dhënave si dhe paraqitjen e rekomandimeve në këtë raport.

Një falenderim i veçantë shkon për përfaqësuesit e organizatave dhe shoqatave që mundësuan dhe lehtësuan takimet me fëmijët pjesëmarrës. Intervistat individuale me fëmijë u realizuan me mbështetjen dhe ndihmën e ofruar nga organizatat Terre des Hommes zyra Fier, Arsis, Fëmijët e Botës Shqipëri (FBSH- DN), shoqata "Sot për të Ardhmen" dhe organizata World Vision, zyra e programit të Tiranës.

Së fundmi, dëshirojmë të shprehim falenderimin tonë më të thellë për gjithë fëmijët që pranuan të marrin pjesë në këtë vlerësim, si dhe ndarjen e mendimeve, opinioneve, rekomandimeve të cilat do të na ndihmojnë për të kuptuar më mirë fenomenin e lëvizjes së fëmijëve.

Projekti MARIO është një projekt rajonal tre vjecar i shtrirë në shtetet: Shqipëri, Kosovë, Poloni, Rumani, Bullgari dhe Hungari. Ky projekt synon të nxisë dhe fuqizojw organizatat dhe rrjetet e shoqwrisw civile në këto shtete për të advokuar për cështjet e mbrojtjes dhe të të drejtave të fëmijëve në nivel ndwrkombwtar pranë EU-së si dhe në nivel nacional pranw qeverive dhe institucioneve pwrgjegjwse. Ky projekt, gjithashtu promovon dhe nxit bashkëpunimet rajonale për të adresuar cështjet ndër rajonale të trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve si dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse sic janë Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve për të ofruar shërbime për mbrojtjen e fëmijëve.

Ky studim është hartuar me mbështetjen e Fondacionit OAK, në kuadër të projektit MARIO dhe në bashkëpunim me organizatat Terre des hommes në Shqipëri dhe Save the Children në Shqipëri. Projeti MARIO financohet nga Fondacioni OAK. Përmbajtja e këtij publikimi jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Fondacionit OAK dhe as nuk nënkupton miratimin e pikëpamjeve të shprehura. Gabimet mbeten përgjegjësi e vetme e autorëve të raportit.

AKRONIME

ARSIS - Shoqata për Mbështetje Sociale të të Rinjve

BKTF - Koalicioni Shqiptar Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve

FBSH - DN - Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë – Të Drejtat e Njeriut

IOM - Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

ISS - Shërbimi Social Ndërkombëtar

KDF - Konventa mbi të drejtat e Fëmijëve

NjMF - Njësia Për Mbrojtjen e Fëmijëve

PNUD/UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri

SKZHI - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Tdh - Terre des hommes

UNHCR - United Nations High Commissioner for Refugees

UNICEF - The United Nations Children's Fund

USAID - United States Agency for International Development

WVA - World Vision Albania

PASQYRA E LËNDËS

PËRMBLEDHJE 6
1. FENOMENI I LËVIZJES.....9
1.1 Ç'është fenomeni i lëvizjes së fëmijëve? 9
1.2 Faktorët nxitës në lëvizjen e fëmijëve 10
1.3 Mënyrat e përshtatjes ndaj situatës së lëvizjes 11
1.4 Pasojat e fenomenit të lëvizjes së fëmijëve 11

2. Përmbledhje e Ligjeve, politikat sociale dhe
shërbimet që prekin fëmijët në lëvizje në Shqipëri.....13
2.1 Legjislacioni vendas i cili trajton çështjet e ripranimit përmblidhet në:.....13
2.2 Konventa mbi të drejta e Fëmijës (KDF).....13
2.3 Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve 14
2.4 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI, 2007-2013).....14
2.5 Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer (2010-2015) 14
2.6 Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale 14
2.7 Strategjia Antitrafik 15

3. METODOLOGJIA 16

4. REZULTATET.....18
4.1. Të dhëna të përgjithshme mbi pjesëmarrësit.....18
4.2. Situata familjare.....18
4.3. Përvoja e lëvizjes së fëmijëve 20
4.4. Shërbimet.....23
4.5. Puna e fëmijëve.....25
4.6. Siguria në komunitet.....26
4.7. Burimet e frikës 26
4.8. Koncepti i fëmijëve mbi lumturinë.....26
4.9. Vizioni për të ardhmen.....27
4.10. Përshtypjet për intervistën 27

5. DISKUTIME 28
5.1. Arsyet e lëvizjes.....29
5.2. Lëvizja (zhvendosja, udhëtimi dhe vendosja në vendin e ri) 29
5.3. Proçesi i përshtatjes.....30
5.4. Pasojat dhe efektet e lëvizjes në jetën e fëmijëve 31
5.5. Kufizimet dhe pikat e forta të vlerësimit.....32

6. REKOMANDIME.....34

7. Referenca.....36

8. ANEKS.....37

PËRMBLEDHJE

Ky raport synon të eksplorojë dhe të evidentojë përvojat, mendimet dhe perceptimet e fëmijëve për fenomenin e lëvizjes së fëmijëve brenda apo jashtë Shqipërisë. Për këtë qëllim, vlerësimi ndoqi një metodologji të natyrës cilësore. Duhet theksuar se ky vlerësim u pëërqëëndrua në grupin e fëmijëve vulnerabël të cilët lëvizin me apo pa familjet e tyre si një mënyrë për të siguruar jetesën pasi nuk gjejnë mundësi të mjaftueshme në vend. Të dhënat mbi lëvizjen e fëmijëve u mblodhën përmes intervistave gjysëm të strukturuara me fëmijë që kishin përvoja lëvizjeje qoftë brenda Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Fëmijët pjesëmarrës janë midis moshës 8-15 vjeç dhe më shumë se gjysma e tyre i përkasin komunitetit Rom. Ata jetojnë aktualisht në zonat urbane dhe rurale të rretheve Tiranë, Durrës dhe Fier. Fëmijët u identifikuan nga organizata dhe shoqata të ndryshme ku ata marrin shërbime të ndryshme psiko-sociale, edukative, argëtuese, mjekësore, ligjore etj. Mbledhja e të dhënave u fokusua në disa çështje kryesore si motivet, përjetimet, rrugët dhe pasojat e lëvizjes.

Kështu midis faktorëve kryesor shtytës të lëvizjes së fëmijëve janë: vështirësitë e mëdha ekonomike në familje, mungesa e mundësive për punësim në vendet e origjinës, joshja e të fituarit para në një kohë të shkurtër apo mundësitë për edukim dhe akses më të mirë në shërbimet shëndetësore.

Lëvizja e këtyre fëmijëve shpesh shoqërohet me ndjenja dhe emocione ambivalente (p.sh. mërzitje për shkak të largimit nga vendi i origjinës, nga shokët dhe mjedisi, si dhe entuziazëm për mundësitë e reja në vendin e mbërritjes). Duke u bazuar në përgjigjet e fëmijëve, vërejmë një ndryshim të lehtë në cilësinë e jetës së tyre pas lëvizjes, i cili mund të jetë rezultat i ofrimit të shërbimeve nga organizata të ndryshme si dhe i sigurimit të mjeteve bazë për të jetuar si rezultat i lëvizjes. Për t'u përballur në mënyrë të suksesshme me ambientin e ri në vendin e mbërritjes, shumë fëmijë përfitojnë aftësi të reja si: gjuhë të huaja ose dialekte të reja, aftësi teknike të përfituara nga punë të ndryshme, apo shprehi të reja socializuese, si dhe aftësi për t'u përballur me situata të vështira dhe forcim të aftësive për të mbijetuar në këto situata. Nga ana tjetër, lëvizja shoqërohet dhe me aspekte negative, si probleme me përshtatjen, abuzim dhe dhunë, trajtim negativ, përfshirje në punë, apo aktivitete lypjeje, mungesë aksesi në shërbimet mjekësore për fëmijët që vijnë nga familje shumë të varfëra ekonomikisht, etj. Fëmijët në disavantazh të madh ekonomik nuk e përjetojnë lëvizjen për punë si shfrytëzim por si detyrim individual dhe pjesë normale të kontributit dhe rolit të tyre në familje. Ky fakt ndikon dhe në vizionin për të ardhmen te fëmijët që lëvizin. Kështu, një pjesë e fëmijëve të intervistuar treguan se kur të rriteshin do të vazhdonin të kryenin të njëjtat punë si lypje apo mbledhje hekurash.

Analiza e mëtejshme e gjetjeve të studimit tregon për praninë e dy profileve kryesore të lëvizjes brenda dhe jashtë vendit. Këto dy profile përcaktohen nga gjendja ekonomike e familjes dhe nevojat që motivojnë familjet të përfshijnë fëmijët në një proçes lëvizjeje. Familjet e varfëra, të cilat në studimin tonë ishin kryesisht familje që i përkasin komunitetit

Rom, lëvizin për të përmirësuar gjendjen ekonomike përmes punës së prindërve dhe të fëmijëve. Lëvizja e tyre është e shpeshtë dhe kjo ka pasoja të mëdha në përshtatjen dhe aksesin e shërbimeve kyçe për fëmijët në vendet e ndryshme. Në rastin e fëmijëve që vijnë nga familje me një gjendje ekonomike relativisht më të mirë, arsyet e lëvizjes së fëmijëve janë të një natyre tjetër. Lëvizja bëhet me qëllim që fëmijët dhe e gjithë familja të kenë mundësi të marrin shërbime arsimore dhe shëndetësore më të mira dhe në mënyrë më të lehtë. Këto lëvizje përfshijnë kohëqendrime të gjata dhe të rralla. Këto dy profile lëvizjesh karakterizohen gjithashtu nga tipare të tjera si natyra e ndryshme e rreziqeve apo e përfitimeve që fëmijët mund të kenë nga lëvizja.

Për shkak të një kampioni të vogël të përzgjedhur qëllimisht, përfundimet e këtij vlerësimi nuk mund të përgjithësohen për të gjitha rastet e fëmijëve që lëvizin brenda dhe jashtë Shqipërisë. Njëkohësisht, ky vlerësi ofron një panoramë të mirë të profileve të ndryshme të lëvizjes së fëmijëve në Shqipëri. Gjithashtu, gjetjet e këtij studimi mund të ofrojnë një bazë të mirë njohurish për hartimin e studimeve empirike me shkallë më të lartë pjesëmarrjeje dhe të përqëndruar më në thellësi në cështje të caktuara. Studime të tilla mund të ndërmerren me fëmijë nga grupe të ndryshme të përcaktuara qartë në varësi të llojit të lëvizjes apo nevojave të fëmijëve. Këto studime do të ndihmonin në formulimin e rekomandimeve konçize dhe operacionale për aktorët kyç që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe në vecanti në lidhje me mënyrat e mbështetjes, ofrimit të shërbimeve, si dhe forcimit të aftësive dhe kapaciteteve të fëmijëve dhe familjeve për të tejkaluar pasojat negative të fenomenit të lëvizjes.

Për të të rritur dobishmërinë e ndërhyrjeve lehtësuese mbi pasojat e lëvizjes së fëmijëve, së pari, ne rekomandojmë futjen e kësaj çështjeje në axhendën e bashkëpunimeve në rang rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar përsa i përket mbrojtjes së fëmijëve. Gjithashtu, një vëmendje më e veçantë në punën me fëmijët që lëvizin apo janë në risk, dhe familjet e tyre mund të ndihmojë në lehtësimin e këtij proçesi.

1. FENOMENI I LËVIZJES

Me rritjen e urbanizimit dhe lëvizjes migratore të popullsisë në të gjithë botën, lëvizja e shoqëruar apo e pashoqëruar e fëmijëve po bëhet gjithmonë e më e shpeshtë. Për shkak të pasojave negative dhe pozitive që sjell në jetën e fëmijëve përvoja e lëvizjes, kjo dukuri po tërheq gjithmonë e më shumë vëmendjen e organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve edhe në Shqipëri. Duke u nisur nga raportet anekdotike që dëshmojnë për lëvizjen e fëmijëve në Shqipëri, si dhe mungesa e njohurive të thelluara e sistematike mbi karakteristikat lokale të kësaj dukurie aktuale në vendin tonë, organizatat Terre des Hommes dhe Save the Children në Shqipëri ndërmorrën iniciativën për të realizuar këtë studim. Ky studim kishte për qëllim të hulumtonte përvojat e lëvizjes së fëmijëve përmes perceptimeve dhe emocioneve të vetë fëmijëve që janë të përfshirë në këto përvoja lëvizjeje. Të dhënat e këtij studimi mund t'u shërbejnë aktorëve kyç qoftë për hartimin e ndërhyrjeve të dobishme për pakësimin e pasojave negative të lëvizjes së fëmijëve, ashtu dhe për hartimin e studimeve më të thelluara mbi këtë dukuri në të ardhmen.

Por çfarë dihet mbi përvojat e lëvizjes së fëmijëve në planin global, rajonal dhe më veçanërisht në Shqipëri? Përpara hartimit të metodologjisë së studimit, u realizua shfletimi dhe rishikimi i literaturës ekzistuese mbi dukuritë e lëvizjes, trafikimit dhe emigrimit të pashoqëruar të fëmijëve. Edhe pse raportet dhe botimet e shfletuara mbi këto dukuri ishin të rralla për Shqipërinë, përsa i përket fokusit të vecantë të studimit, ato ofruan disa njohuri mbi fushat e ndryshme të jetës së fëmijëve të ndërlidhura dhe të ndikuara nga proçesi i lëvizjes së tyre.

1.1 Ç'është fenomeni i lëvizjes së fëmijëve?

Çdo ditë shumë fëmijë lënë vendet e origjinës për arsye të ndryshme si varfëria, papunësia e prindërve, mungesa e mundësive për edukim dhe zhvillim, apo për shkak të luftërave dhe katastrofave natyrore. Fëmijët lëvizin vetëm ose së bashku me familjen, duke u përballur me rreziqe por edhe mundësi me rrjedhoja të rëndësishme për jetën e tyre. Procesi i vajtjes dhe vendosjes në një vend të ri mbart rreziqe për abuzim, keqtrajtim, shfrytëzim për punë apo prostitucion. Shpeshherë, edhe përshtatja me vendndodhjen e re mund të jetë e dhimbshme. Për shkak të statusit të emigrantit dhe zhvendosjes për kohë të gjata, fëmijët nuk mund të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre për të pasur akses në shërbimet publike si ato shëndetësore, sociale dhe arsimore (Reale, 2008). Nga ana tjetër, ndonjëherë ndodh që lëvizja e përmirëson sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës. Kështu, duke pasur më shumë mundësi punësimi në vendet e mbërritjes, si dhe një kontekst më të zhvilluar me mundësi më të mira për shërbime për fëmijët dhe familjen, rrjedhimisht cilësia e jetës së tyre mund të rritet. Gjatë lëvizjes, fëmijët mund të përvetësojnë gjithashtu aftësi të reja, si mësimi i gjuhëve të huaja, aftësi teknike dhe ato sociale.

Ashtu si në planin global, lëvizja e fëmijëve përbën një dukuri sociale të përhapur në rajonin e Ballkanit, dhe veçanërisht në Shqipëri. Edhe pse mungojnë shifra të plota mbi lëvizjen e fëmijëve brenda dhe jashtë vendit, studimet e kryera më parë mbi fenomenin e trafikimit dhe emigrimit të pashoqëruar tregojnë se lëvizja e fëmijëve është një fenomen ekzistues si dhe me pasoja konkrete në jetën e fëmijëve shqiptarë (Orgocka & Jasini, 2007; Orgocka, 2010). Lëvizja e fëmijëve është një term më gjithëpërfshirës sesa trafikimi apo lëvizja e pashoqëruar e fëmijëve. Sipas raportit të "Save The Children" (Reale, 2008), lëvizja e fëmijëve përfshin jo vetëm elementë të trafikimit të fëmijëve, por edhe të emigrimit të shoqëruar dhe të pashoqëruar si dhe zhvendosjen apo shpërnguljen e fëmijëve si rezultat i luftërave apo katastrofave natyrore. Lëvizja e fëmijëve ndodh brenda dhe jashtë kufijve të një shteti të caktuar. Ajo mund të ndodhë vetëm apo bashkë me familjen ose me fëmijë të tjerë të komunitetit. Karakteristika kryesore që e dallon lëvizjen e fëmijëve nga fenomeni i

trafikimit është shfrytëzimi që lidhet me të dhe pse ky i fundit mbetet një risk i mundshëm shoqërues i përvojës së lëvizjes. Në të vërtetë, përqasja e problemit e etiketuar si "fëmijët në Lëvizje" është një qasje e re kërkimi dhe programimi në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Sipas saj, fëmija nuk shihet vetëm në perspektivën e viktimës, gjë që është pjesë e të kuptuarit të trafikimit. Përkundrazi ndonjëherë lëvizja e fëmijëve mund të ofrojë mundësi më të mira në jetën e tyre nga ato të vendit të origjinës. Gjithashtu vetë lëvizja mund të jetë një mundësi për fuqizimin dhe rritjen e aftësive të fëmijëve dhe përballimin e vështirësive në jetë. Në këtë mënyrë, kjo përqasje e re mund të ofrojë një të kuptuar më të mirë të vështirësive, sfidave por njëkohësisht dhe të mundësive që fëmija mund të ndeshë gjatë dhe pas lëvizjes.

Pavarësisht shkallës së lartë të përhapjes së fenomenit të fëmijëve në lëvizje në Shqipëri dhe në botë, si edhe rreziqeve që mbart për fëmijët, ende ka pak studime të mirëfillta për këtë çështje. Gjithashtu, përpjekjet e organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve për të lehtësuar procesin e fëmijëve në lëvizje janë ende modeste dhe në hapat e para. Studime të realizuara në vende të ndryshme (Boland, 2010; Yaqub, 2009; Orgocka 2010; Shenoy, 1996) flasin mbi arsyet, rrugët dhe mënyrat e lëvizjes, përjetimet emocionale, mënyrën sesi fëmijët përballen me lëvizjen dhe përshtatjen me vendin e ri. Gjithsesi, për sa i përket kontekstit shqiptar, mungon informacioni i strukturuar sidomos në lidhje me lëvizjen brenda vendit dhe mekanizmat e përshtatjes së fëmijëve në vendet e mbërritjes. Për më tepër, ka pak informacion në lidhje me mënyrat sesi fëmijët e përfshirë në lëvizje kanë akses në shërbimet bazë si ato sociale, shëndetsore, të edukimit, apo të mbrojtjes në vendbanimet e tyre të reja.

Për të patur një informacion më të detajuar në lidhje me fenomenin e fëmijëve në lëvizje në Shqipëri, ky studim synon të hulumtojë disa aspekte të përvojës së lëvizjes tek fëmijët siç janë: faktorët shtytës që çojnë në lëvizjen e fëmijëve dhe roli i fëmijëve në vendimin për të lëvizur, mënyrat e lëvizjes, pasojat pozitive dhe negative të saj dhe përshtatja në vendndodhjen e re. Njohuritë mbi këto çështje mund të ndihmojnë organizatat dhe institucionet e interesuara në adresimin e mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve në lëvizje.

1.2 Faktorët nxitës në lëvizjen e fëmijëve

Lëvizja e fëmijëve ndodh për shkak të faktorëve të ndryshëm. Ata mund të klasifikohen në faktorë individualë, familjarë si dhe socialë/komunitarë. *Faktorët individualë* lidhen me plotësimin e nevojave personale të fëmijës, si nevojat shëndetësore, për arsim, për zhvillim, për siguri, mundësi më të mira jetese, etj. Ndërkohë *faktorët familjarë apo socialë* ndikojnë në jetesën e të gjithë familjes apo komunitetit, shoqërisë në të cilën fëmija bën pjesë. Studimet e ndryshme tregojnë se ndër nxitësit kryesorë të lëvizjes së fëmijëve janë: varfëria në familje, mundësitë e pakta për t'u arsimuar, abuzimi në familje, konfliktet në komunitet, paragjykimet dhe diskriminimi në shkollë dhe në komunitet (Reale, 2008).

Varfëria, e lidhur ngushtë me mundësitë e pakta për punësim, mund të shtyjë fëmijët të ndryshojnë vendndodhjen e tyre, vetëm apo së bashku me familjen e tyre. Largimi dhe vendosja në një vend ku edhe fëmijët mund të punojnë mund të rrisë shanset për mbijetesë, jo vetëm të fëmijës por të të gjithë familjes. Në rastet kur fëmija zhvendoset jashtë vendit për të punuar apo për t'u edukuar, shpeshherë familjet detyrohen të marrin borxh për t'i dërguar fëmijët jashtë vendit.

Mundësitë e pakta për edukim të mirë dhe cilësor në vendet rurale dhe të pazhvilluara i nxisin familjet t'i dërgojnë fëmijët larg vendit të origjinës, në qytete apo jashtë vendit. Një arsye tjetër mund të jetë abuzimi në familje dhe në komunitet. Për t'i shpëtuar dhunës dhe abuzimit, fëmijët largohen në drejtim të një vendi më të sigurtë. Gjithashtu, diskriminimi i fëmijëve në shkolla apo ambiente të tjera të komunitetit, mund t'i detyrojë fëmijët që të lënë vendndodhjen ekzistuese (Reale, 2008). Ndryshime në strukturën familjare, pakësimi i të ardhurave prej vdekjes së një apo të dy prindërve, mund të sjellë një përkeqësim të gjendjes ekonomike të familjes dhe si rrjedhojë largimin e fëmijëve drejt një qyteti apo shteti

tjetër. Disa studime të realizuara në Shqipëri (Orgocka, 2010; Orgocka & Jasini, 2007) tregojnë gjithashtu se premtimet apo shembujt e ofruar nga anëtarë të tjerë të komunitetit, në lidhje me të ardhura të mira të përftuara në një shtet tjetër mund të frymëzojnë fëmijët të emigrojnë. Shkaqe të tjera të mundshme mund të jenë largimi për shkak të përndjekjes nga institucionet ligjore ose martesa e detyruar nga familja.

Gjithashtu, në rastet e migrimit jashtë vendit, fëmijët shpesh bëhen ose pjesë e vendimmarrjes së prindërve për t'u larguar ose e inicojnë vetë këtë përpjekje (Reale, 2008, Boland, 2010). Pavarësisht kësaj, fëmijët në të shumtën e rasteve janë të painformuar në lidhje me udhëtimin dhe vendin e mbërritjes.

1.3 Mënyrat e përshtatjes ndaj situatës së lëvizjes

Në situatën e lëvizjes, fëmijët janë të detyruar të përballen me disa sfida të reja të shoqëruara me pasoja të rëndësishme për jetën e tyre. Kështu, studime mbi lëvizjet ndërkombëtare kanë treguar se emigrimi shoqërohet me ndryshime social-kulturore dhe gjendje të ngarkuara psikologjike te fëmijët prej faktorëve të shumtë të stresit në vendet e mbërritjes (Shenoy, 1996). Gjatë proçesit të përballjes me situatën e re, fëmijët mund të zhvillojnë shprehi të reja (sociale, komunikimi ose të mësojnë një gjuhë apo dialekt të ri), aftësi (në tregun e punës), teknika dhe strategji të cilat i ndihmojnë të përshtaten.

Përballimi i një situate të re, ka të bëjë gjithashtu edhe me pranimin e saj, p.sh. edhe pse fëmija mund të braktisë shkollën, ai mund të vazhdojë normalisht jetën e tij. Duke u bazuar në modelin multimodal të vlerësimit konjitiv dhe emocional të Scherer (2001) për të shpjeguar përballimin emocional të një situate të re dhe të panjohur, kuptojmë se njerëzit kalojnë nëpër disa hapa vlerësimi të situatës dhe të aftësive vetjake. Këto hapa janë: pranimi i situatës së re, dhënia e një kuptimi, reflektimi mbi mënyrat e përballjes dhe integrimi i njohurive të mëparshme me të dhënat e situatës së re. Edhe pse ky model është hartuar për të kuptuar proçesin e shpejtë konjitiv që ndodh gjatë zhvillimit të një emocioni të caktuar, ai mund të përdoret për të kuptuar përjetime emocionale episodike në përballjen me faktorë të ndryshëm stresant në një proces afatgjatë përshtatjeje.

Aftësia për të përballuar situata të reja dhe të vështira është përkufizuar si "sjellje dhe mendime të ndryshueshme që njerëzit përdorin zakonisht për të menaxhuar kërkesat e një situate e cila vlerësohet si stresuese ose shterruese ndaj burimeve të personit" (Lazarus & Folkman, 1984, p. 141). Edhe pse përdoren shumë forma përballimi, tre prej tyre njihen si më të suksesshmet: (a) *forma e përballimit e fokusuar te mendimet dhe besimet rreth situatës së re,* (b) *forma e përballimit e fokusuar te zgjidhja e problemit*, dhe (c) *forma e përballimit e fokusuar te menaxhimi i emocioneve* (Weiten & Lloyd, 2008). Në aftësitë për të përballur a zgjidhur një situatë, mund të ndikojnë: faktorët e personalitetit, mënyrat e ndryshme të rritjes, faktorët kulturorë të grupit etnik në të cilën fëmija bën pjesë, historiku i përballimit të situatave të vështira në të kaluarën, etj.

Sipas një studimi të realizuar nga Shenoy (1996), përshtatja e fëmijëve me situatën e re të emigrimit përfshin dy forma, psikologjike dhe atë socio-kulturore: *Përshtatja psikologjike* shprehet kryesisht përmes gjendjeve të ankthit dhe shqetësimit të cilat luhaten me kohën e qëndrimit në vendin e ri si dhe mënyrat se si fëmijët përballen emocionalisht me situatat e reja (Shenoy, 1996). Ndërkohë, *përshtatja social-kulturore* lidhet me mënyrën e përballimit të fëmijëve me kulturën dhe mjedisin e ri. Sipas gjetjeve të studimit, kjo ndikohet nga koha e qëndrimit, mekanizmat individualë të përballimit, mbështetja sociale dhe perceptimi i ndryshimit mes kulturës së vendit të origjinës dhe asaj të vendit të mbërritjes (Shenoy, 1996).

1.4 Pasojat e fenomenit të lëvizjes së fëmijëve

Mbas një kërkimi bibliografik u ndeshëm me një mungesë informacioni mbi koston sociale afatgjatë dhe afatshkurtër të lëvizjes së fëmijëve. Edhe ato studime që ekzistojnë

flasin për emigrimin jashtë vendit dhe kryesisht përqëndrohen te prindërit dhe pasojat e emigrimit të tyre te fëmijët. Kështu, ka pak studime mbi impaktin social-ekonomik dhe psikologjik të lëvizjes brenda vendit te fëmija. Po ashtu, mungojnë studime sasiore mbi impaktin e lëvizjes në përmbushjen e nevojave arsimore dhe nevojave të tjera bazë të tyre.

Disa studime të mëparshme tregojnë se lëvizja e fëmijëve ka një kosto sociale e cila shoqërohet si me pasoja negative ashtu edhe pozitive. Duke marrë në konsideratë rreziqet që fëmijët mund të hasin gjatë lëvizjes dhe pas vendosjes në vendin e ri, kategoritë më të rrezikuara përfshijnë fëmijët e pashoqëruar nga të rriturit, ato me aftësi të kufizuara, fëmijët e minoriteteve, në moshë të vogël dhe ato që vijnë nga situata familjare dhe ekonomike të vështira si dhe vajzat (që rrezikohen nga trafikimi dhe prostitucioni) (Reale, 2008; Boland, 2010).

Kostoja sociale e lëvizjes mund të përcaktohet nga këta faktorë:

- Fëmijët që lëvizin, janë në rrezik abuzimi seksual apo/dhe shfrytëzimi në punë.
- Kryesisht këta fëmijë hasin barriera kur duan të përfitojnë nga sistemi i arsimit apo i shëndetësisë në vendin e mbërritjes. Kjo mund të bëjë që ata të ndihen të diskriminuar.
- Disa prej tyre nuk arrijnë të kenë çertifikatë lindjeje apo dokumenta të tjerë që duhen siguruar në vendin e origjinës.
- Një pjesë e fëmijëve për shkak të lëvizjes, izolimit social, kulturës së tyre, varfërisë dhe barrierave të gjuhës mund të braktisin shkollën.
- Disa largohen nga shtëpia për të pasur një aktivitet ekonomik, shpesh herë në kushte të vështira pune dhe me pagesë të ulët.
- Në shumicën e rasteve, ata jetojnë në kushte shumë të vështira jetese.
- Ndonjëherë vajzat emigrojnë për t'u martuar në moshë të hershme. Kjo vjen si pasojë e mentalitetit sipas të cilit vajza e ka vendin te shtëpia e burrit dhe duhet të shkojë aty sa më parë.
- Gjatë lëvizjes, fëmijët që lëvizin të pashoqëruar ndahen nga familja, të afërm apo shokë të vendit të origjinës.
- Probleme që shoqërojnë moshën e adoleshencës (aftësi në vendimmarrje, aftësi për t'u përballur me jetën, për të mësuar etj) mund të theksojnë pasojat e lëvizjes te fëmijët.

Për shkak të mungesës së kujdesit prindëror, te fëmijët që lëvizin të pashoqëruar, kostoja mund të jetë akoma më e lartë.

Disa nga pasojat e lëvizjes në sjelljen dhe gjendjen emocionale të fëmijëve janë:

- Probleme sociale (izolim/ tërheqje nga jeta sociale).
- Braktisje e shkollës.
- Efekte psikosociale në shëndetin mendor, si ankth, stres dhe depresion.
- Probleme të tjera emocionale (të qara pa arsye, nervozizëm etj).
- Pasiguri materiale.
- Paftësi për t'u kthyer në shtëpi.

Gjithsesi, kur ndodh në situata të sigurta, ajo mund të shoqërohet edhe me disa anë pozitive:

- Lëvizja e fëmijëve (shpeshherë së bashku me familjen) mund të luajë një rol të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për familjen.
- Ajo mund të rrisë aftësinë e fëmijëve për të përballuar vështirësi në të ardhmen.
- Fëmijët mund të shkojnë në shkolla më të mira se ato që kishin në fshatin apo qytetin e tyre.
- Aksesi që kanë për shërbime cilësore shëndetësore mund të rritet, p.sh.: fëmijët që lëvizin nga një zonë rurale në një zonë urbane mund të mbijetojnë më shumë për shkak të numrit të madh të doktorëve, të informacionit më të madh mbi shëndetin në spitale si dhe infrakstrukturës më të zhvilluar (p.sh.: uji i pijshëm).
- Ata mund të formojnë miqësi të reja.
- Ata mund të realizojnë qëllime që kanë pasur në jetë.
- Fëmijët mund të bëhen shumë më të pavarur se bashkëmoshatarët e tyre dhe ndonjëherë mund të fitojnë status më të lartë në grupin e tyre.

2. PËRMBLEDHJE E LIGJEVE, POLITIKAT SOCIALE DHE SHËRBIMET QË PREKIN FËMIJËT NË LËVIZJE NË SHQIPËRI

Mbas viteve 90-të, Shqipëria është karakterizuar nga lëvizje të mëdha demografike dhe flukse migratore në vend. Kështu, u kalua nga një ndalim total i lëvizjes së lirë gjatë periudhës së komunizmit, në një shpërngulje masive të popullsisë rurale drejt qendrave urbane apo nga një qytet në tjetrin. Shumë familje u shpërngulën drejt qyteteve të mëdha në qendër dhe sidomos drejt Tiranës dhe Durrësit. Gjithashtu, emigracioni është një shqetësim i madh për Shqipërinë sepse rreth 20% e popullsisë është larguar nga vendi gjatë më shumë se një dekade, duke e bërë Shqipërinë një nga vendet me nivelin më të lartë të flukseve të emigracionit në botë.

Por cilat janë ligjet dhe politikat që i mbrojnë "fëmijët në lëvizje" në Shqipëri? Si kanë akses ata për shërbime në vendbanimet e tyre të reja apo të përkohshme? Më poshtë do të vijojmë me një panoramë të ligjeve, politikave sociale dhe shërbimeve më të rëndësishme që ofrohen dhe mbrojnë fëmijët që emigrojnë:

2.1 Legjislacioni vendas i cili trajton çështjet e ripranimit përmblidhet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë[1],
- Ligji për Policinë e Shtetit, nr. 9749, datë 04.05.2007, botuar në Fletoren Zyrtare nr 73, Faqe 2171, datë 19-06-2007, hyrë në fuqi datë 04.07.2007;
- Ligji nr. 9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 124, Faqe 5479, datë 01-08-2008 dhe hyrë në fuqi në datë 1.12.2008.

Marrëveshja midis Komunitetit Europian dhe Shqipërisë mbi lehtësimin e dhënies së vizave hyri në fuqi në 15 dhjetor 2010. Kjo marrëveshje ka ndikuar në rritjen e qarkullimit të lirë të familjeve dhe fëmijëve shqiptarë në vendet pjesëtare të Komunitetit Europian.

2.2 Konventa mbi të drejta e Fëmijës (KDF)

Te kjo konventë nenet më të rëndësishme që mbrojnë fëmijët që emigrojnë kanë në fokus fëmijët me status refugjati (neni 22), fëmijët në konflikte të armatosura (neni 38) duke synuar rikuperimin fizik dhe psikologjik dhe ri-integrimin shoqëror të tyre (neni 39), fëmijët që i përkasin minoriteteve (neni 30), si dhe fëmijët e privuar nga liria, duke përfshirë

1. Neni 84, datë 21.10.1998, botuar në fletoren zyrtare nr.28, datë 07.12.1998, faqe 1073;

çdo formë ndalimi, burgosjeje, apo vendosje në ambiente të mbikqyrura (neni 37 (b), (c)). Po ashtu disa nga nenet e kesaj konvente synojnë parandalimin dhe trajtimin e dënimit të fëmijëve, në veçanti ndalimi i dënimit kapital dhe burgimit të përjetshëm (neni 37 (a)), parandalimin dhe trajtinim e shfrytëzimit e fëmijëve për punë (neni 32), shfytëzimit dhe abuzimit të formave të tjera si ai seksual, shitja, trafikimi, rrëmbimi (neni 34, 36, 35), si dhe abuzimit me drogat (neni 33).

2.3 Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri i miratuar në datën 4.11.2010 përfshin shumë prej aspekteve kryesore të mbrojtjes së fëmijëve të përmbledhura edhe në Koventën mbi te Drejtat e Fëmijës. Disa prej neneve të këtij ligji aplikohen më vecanërisht në rastet e fëmijëve që kanë emigruar në mënyrë të shoqëruar ose jo. Këto nene përfshijnë nenin 7 që përqendrohet te e drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe për të ruajtur identitetin, nenin 10 mbi të drejtën për të siguruar kthimin e fëmijëve si dhe më tej nene të tjera që parashikojnë të drejta për akses të barabartë dhe pa diskriminim në edukim dhe shërbime shëndetësore, të drejta për mbrojtje nga shfrytëzimi, dhuna, abuzimi, etj të cilat përbëjnë disa nga rreziqet gjatë lëvizjes. Më tej ky ligj përcakton mekanizmat institucionalë qendror dhe vendor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëvs si dhe detyrimet e tyre.

2.4 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI, 2007-2013)

Politika migratore e Republikës së Shqipërisë përbëhet nga politikat emigratore dhe imigratore të shprehura këto në normativën migratore të hartuar dhe miratuar për këtë qëllim, e cila është në përputhje me normativën e BE-së. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, e cila përfaqëson kuadrin strategjik për politikat dhe reformat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, përfshin edhe vizionin e Qeverisë në lidhje me migracionin, i cili është trajtuar gjerësisht në Strategjinë Kombëtare për Migracionin.

Ky vizion konsiston në sigurimin e një politike më të plotë për migracionin, të bazuar në ngritjen dhe funksionimin e një sistemi kombëtar menaxhues të migracionit. Politikat migratore për shtetasit shqiptarë, synojnë minimizimin e kostove të migracionit dhe maksimizimin e përfitimeve si për emigrantët, ashtu dhe për vendin, përmes parandalimit të migracionit të parregullt, nxitjes së kthimit vullnetar dhe promovimit të lidhjes migracion-zhvillim i vendit.

2.5 Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer (2010-2015)

Kjo, strategji është pjesë e politikave kombëtare për migracionin. Ajo zgjeron më tej parashikimet e Strategjisë Kombëtare për Migracionin në lidhje me riintegrimin e emigrantëve shqiptarë të kthyer, të cilat nuk adresojnë në mënyrë të plotë çështjet e ri-integrimit. Vizioni i saj është sigurimi i një kthimi të qëndrueshëm për emigrantët përmes mbështetjes së proçesit të riintegrimit, pavarësisht formës së kthimit.

2.6 Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale

Kjo strategji është një komponent i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Kjo strategji e ka burimin nga strategjitë e Mbrojtjes Sociale, Punësimit, Arsimit, Shëndetësisë, Transportit, Furnizimit me Ujë, Planifikimit Urban dhe Drejtësisë, të

cilat janë miratuar ose janë në proces formulimi. Ajo duhet parë në lidhje me Strategjitë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural, kundër Krimit të Organizuar, Terrorizmit dhe Trafikimit, të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, të Rinisë, Informacionit dhe Teknologjisë së Komunikacionit dhe asaj të Decentralizimit. Në këtë strategji një vëmendje e veçantë u është kushtuar çështjeve të fëmijëve, veçanërisht kategorive të fëmijëve që janë më vulnerabël e që përbëjnë rrezik përjashtimi social.

2.7 Strategjia Antitrafik

Plani kombëtar i veprimit për "luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore" synon identifikimin e viktimave të trafikimit në kufi (vendosjen e një punonjësi social në kufi), ngritjen e kapaciteteve profesionale të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, si në nivel të përgjithshëm, ashtu edhe në atë të specializuar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Gjithashtu, ky plan përshin dhe funksionimin e linjës telefonike falas 0 800 12 12, si dhe caktimin e një psikologu, punonjësi social në operimin e kësaj linje.

Ky plan dhe dokumenti plotësues "plani i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve viktima të trafikimit" që u miratua më datë **23.2.2011** parashtron detyrimet e ministrive, si dhe institucionet e tjera qendrore e vendore për zbatimin e këtij vendimi. Gjithashtu ky plan përcakton detyrën e Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për monitorimin e zbatimit të këtyre planeve të veprimit.

3. METODOLOGJIA

Ky studim u realizua me fëmijë të cilët kanë një përvojë të lëvizjes brenda apo jashtë Shqipërisë për arsye pune apo banimi. Pjesëmarrësit u përzgjodhën qëllimisht nga organizatat jo fitimprurëse të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për fëmijë dhe janë pjesë e koalicionit BKTF. Këto organizata janë Arsis, Fëmijët e Botës Shqipëri, World Vision, Terre des Hommes dhe Qendra Komunitare "Sot për të Ardhmen". Fëmijët e identifikuar ishin fëmijë me të cilët këto organizata kanë krijuar një marrëdhënie të vazhdueshme. Përveç kriterit të përvojës së lëvizjes, një kriter tjetër që u përdor në përzgjedhjen e fëmijëve ishte dhe ai i moshës. Duke qënë se instrumenti i përdorur në këtë studim ishte intervista individuale, u mendua që fëmijët pjesëmarrës të ishin jo më të vegjël se 8 vjeç. Për të mbledhur të dhëna të larmishme mbi këtë fenomen, u synua gjithashtu që fëmijët e intervistuar të vinin nga familje me karakteristika të ndryshme sociale dhe ekonomike, si dhe zona gjeografike të ndryshme. Po ashtu, fëmijët pjesëmarrës i përkisnin komunitetit Rom dhe jo-Rom dhe aktualisht banonin në zona urbane, peri-urbane dhe rurale të Tiranës, Durrësit dhe Fierit.

Studimi përdori një metodologji të natyrës cilësore dhe instrumenti i përzgjedhur për mbledhjen e të dhënave ishte intervista gjysëm e strukturuar. Intervista u bazua në një listë pyetjesh të hapura dhe të përgatitura paraprakisht nga studiueset në bashkëpunim me stafin e Terre des Hommes dhe Save the Children Shqipëri. Këto pyetje u ndërtuan duke marrë parasysh qëllimin e studimit si dhe gjetjet e mëparshme të realizuara mbi fenomenin e lëvizjes së fëmijëve apo emigrimin në vende të tjera dhe Shqipëri.

Pyetjet u organizuan në seksionet e mëposhtme: a) të dhëna të përgjithshme për fëmijën, b) situata familjare, c) përvoja e lëvizjes, ç) akesi te shërbimet bazë (të edukimit, shëndetit dhe mbrojtjes), d) puna e fëmijëve, e) siguria në komunitet, f) roli i fëmijëve në vendimmarrje, g) mënyrat e disiplinimit dhe shpërblimit, h) burimet e frikës, i) koncepti i fëmijëve për lumturinë dhe j) vizioni i fëmijëve për të ardhmen.

Gjithsej u realizuan 20 intervista (40-60 min). Ato u realizuan në ambjentet e Qendrës Komunitare "Shtëpia e Ngjyrave", organizatës Fëmijët e Botës Shqipëri-DN, pranë një bari që shërben si qëndër për takime komunitare në fshatin Drizë në Fier, zyra e psikologut të shkollës 9-vjeçare në lagjen Kënetë në Durrës si dhe në ambjentet e qendrës komunitare të World Vision, programi i Tiranës në Bathore.

Procesi i intervistimit kaloi nëpër këto hapa. Në fillim, fëmijët kontaktoheshin nga përfaqësues të organizatave të përfshira në studim. Gjatë kësaj kohe përfaqësuesit u përshkruanin fëmijëve qëllimin e vlerësimit, proçesin e intervistës dhe shpjegonin se biseda do të kishte në fokus përvojat e tyre të lëvizjes në vende të ndryshme. Pas prezantimit me intervistueset, fëmijët prezantoheshin me qëllimin e studimit dhe formën e pyetjeve që do të vijonin. Gjithashtu fëmijëve u bëhej e ditur se nëse dëshironin ta mbyllnin intervistën më parë për arsye të ndryshme, ishtin të lirë ta bënin. Më tej, pas miratimit të fëmijëve, intervista fillon me seksionet e përmendura më sipër. Gjatë kalimit nga një seksion pyetjesh në tjetrin, fëmijët inkurajoheshin dhe vlerësoheshin për kontributin e tyre të vazhdueshëm dhe informoheshin për tematikën e pyetjeve të ardhshme. Në fund të intervistës fëmijët u pyetën për mënyrën sesi u ndjenë gjatë intervistës. Dy prej intervistave u lanë përgjysëm pasi fëmijët duhet të largoheshin nga qëndrat për të ndjekur aktivitete të tjera. Në këto raste, ne vendosëm që intervistat të mos vazhdonin në një takim të dytë pasi shkëputja mund të ndikonte në përgjigjet e dhëna. Gjithashtu në rastet kur fëmijët kishin momente me ngarkesë emocionale dhe përlotje, sepse pyetjet ngacmonin tema të dhimbshme për ta, intervista ndërpitej për pak minuta për t'u vazhduar më vonë me pyetje të tjera. Mbasi fëmijës i lihej kohë për t'u qetësuar për disa minuta, atij/asaj i shpjegohej se reagime të tilla ishin normale dhe si shkak i gjithë përvojës së tyre. Më pas fëmijët pyeteshin nëse kishin

dëshirë të vazhdonin.

Të dhënat e intervistave u regjistruan përmes njërës prej studiuesve e cila mbante shënim përgjigjet e fëmijëve. Për shkak të vështirësive gjuhësore që fëmijët Romë në fshatin Drizë shfaqën, intervistat me ta u realizuan me ndërmjetësimin e një anëtari të komunitetit.

Analiza e të dhënave u realizua duke përdorur kategorizim tematik të përgjigjeve rreth çështjeve të ndryshme si marrëdhëniet familjare, kushtet e banimit, puna e fëmijëve, përvoja e lëvizjes, etj. Për të kuptuar edhe më thellë lëvizjen e fëmijëve si një fenomen zinxhir i përbërë nga disa hapa dhe i ndikuar nga disa faktorë të natyrave të ndryshme, ne i integruam këto kategori dhe formuam kategori të reja si: arsyet e lëvizjes, përvoja e lëvizjes, proçesi i përshtatjes dhe pasojat e lëvizjes. Pas kategorizimit të nivelit të parë, u vu re se përvojat e lëvizjeve dhe proçeset e përshtatjeve psikologjike ndryshonin midis fëmijëve me nevoja të ndryshme. Për qëllime intepretimi të të dhënave, fëmijët u kategorizuan në dy grupe, në varësi të shkallës së nevojave të paplotësuara. Grupi i parë përbëhet nga fëmijët që vijnë nga familje me vështirësi të mëdha ekonomike. Ky grup përbëhet kryesisht nga fëmijë Rom. Grupi i dytë i fëmijëve vijnë nga familje që janë vendosur rishtazi në zonat peri-urbane të Tiranës dhe Durrësit, nevojat e të cilëve janë të ndryshme nga ato të grupit të parë.

4. REZULTATET

4.1. Të dhëna të përgjithshme mbi pjesëmarrësit

Në këtë studim, morrën pjesë 20 fëmijë të grupmoshës 8 – 15 vjeç. Mosha mesatare e pjesëmarrësve është 12 vjeç. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë meshkuj (12 fëmijë) dhe pjesa tjetër janë vajza (8 fëmijë). Gjithashtu, pjesa më e madhe e fëmijëve (12 fëmijë) i përkasin komunitetit Rom. Trembëdhjetë pjesëmarrës banojnë aktualisht në Tiranë dhe rrethinat e saj, pesë në fshatin Drizë të Fierit dhe dy në zonën e Kënetës në Durrës.

4.2. Situata familjare

a) Kushtet e shtëpisë

Fëmijët pjesëmarrës vijnë nga familje me numër relativisht të lartë anëtarësh. Ndërsa shtatë fëmijë raportojnë se kanë jo më shumë se pesë anëtarë në familje, pjesa tjetër raportojnë bashkëjetesën e 6-15 personave në një shtëpi.

Një pjesë e fëmijëve jetojnë në barrake (shtatë prej fëmijëve të intervistuar) ose në shtëpi me blloqe (një prej fëmijëve të intervistuar) me një ose dy dhoma. Dymbëdhjetë fëmijë tregojnë se jetojnë në apartamente (vetëm në Tiranë) dhe shtëpi të ndërtuara me tulla. Në shtëpitë-barraka, ato të ndërtuara me blloqe, si dhe në shtëpitë me tulla të të intervistuarve në Fier kushtet e banimit janë të këqia. Ambientet janë të vogla dhe shpesh të mbipopulluara. Në rastet e tjera, shtëpitë ofrojnë kushte më të mira për ngrohje si dhe hapësira personale është më e madhe.

Pjesa më e madhe e fëmijëve treguan se shtëpitë në të cilat jetojnë janë të tyret (këtu përfshihen edhe ata që jetojnë me të afërmit, si xhaxhallarë dhe gjyshër). Disa prej fëmijëve që jetojnë në shtëpi-barraka thanë se barrakat ishin ndërtuar nga baballarët e tyre. Të tjerë pohuan se paguanin qera për banesat e tyre aktuale.

b) Gjendja ekonomike e familjes

Dy prej fëmijëve të intervistuar kanë të paktën një prind të punësuar. Prindërit e fëmijëve të tjerë (kryesisht baballarët apo gjyshërit) punojnë në punë private, lypin, mbledhin hekura, hapin kanale apo punojnë me llamarina. Shumica e nënave janë të papuna, lypin, qepin këpucë në shtëpi ose shesin rroba të vjetra me bashkëshortët dhe fëmijët e tyre. Disa prej fëmijëve treguan se në vendet e mbërritjes prindërit bëjnë të njëjta lloje punësh si në vendet e origjinës. Bëhet fjalë këtu për aktivitete si lypja apo mbledhja e hekurave dhe kanaçeve.

Për familjet që kanë jetuar në Greqi për periudha të gjata si dhe ata të vendosur në zonat peri-urbane të Tiranës dhe Durrësit, pas vendosjes në vendbanimet e reja, prindërit janë përfshirë në lloje të reja pune. Sipas gjetjeve, edhe kur prindërit gjejnë mundësi pune, këto të ardhura me vështirësi plotësojnë kushtet minimale të jetesës si: pagesa e qerasë dhe ushqimi.

Ndërkaq, disa prej fëmijëve të intervistuar janë gjithashtu të përfshirë në punë të ndryshme që sigurojnë të ardhura për familjen. Madje, në aktivitete fitimprurëse si lypja dhe mbledhja e kanaçeve mund të jetë e përfshirë e gjithë familja.

Fëmijët tregojnë gjithashtu se përveç punës së prindërve, të vëllezërve dhe motrave dhe punës së vetë fëmijëve, familjet kanë edhe burime të tjera të ardhurash. Kështu, në një prej rasteve xhaxhai i njërit prej fëmijëve merrte një pension mujor si "i pa-aftë mendor". Ndërsa në një rast tjetër, vetë fëmija merrte një pension mujor për shkak të sëmundjes kronike të veshkave. Raportimi i burimeve të të ardhurave në familje tregon se fëmijët janë të informuar për gjendjen ekonomike të familjes. Kjo mund të ndodhë për disa arsye: së pari pasi ata janë gjithashtu sigurues të ardhurash në shtëpi përmes punës së tyre dhe së dyti, duke jetuar në shtëpi të mbipopulluara, fëmijët janë shumë të ekspozuar ndaj bisedave në lidhje me gjendjen ekonomike të familjes. Po ashtu, në këto familje, nevojat ekonomike

shpesh janë ekstreme dhe kështu lehtësisht të dallueshme për fëmijën.

> Femër, 10 vjeç:
> *"Ne jemi 6 veta në familje: mami, babi, gjyshja, gjyshi, xhaxhai që ka probleme mendore dhe unë. Vetëm xhaxhai merr pension, ndërsa ne dalim dhe lypim të gjithë në Kosovë. Kemi qënë një vit në Kosovë. Vetëm gjyshi lyp në Fier. "*

c) Marrëdhëniet familjare

Të dhënat në lidhje me marrëdhëniet prind-fëmijë, të raportuara nga vetë fëmijët, janë të ndryshme. Disa fëmijë treguan se prindërit sillen mirë me ta, se i mbështesin dhe kujdesen për ta. Ndërkohë, të tjerë fëmijë treguan se nënat mund t'u bërtasin, qëllojnë, shkulin flokët apo të përdorin forma të tjera të ndëshkimit fizik si rrahja, në rastet kur ata përshihen në zënka me shokët dhe vëllezërit, ndotin shtëpinë, etj.,. Disa prej tyre madje treguan se ndonjëherë kanë frikë të kthehen në shtëpi, për shkak të ndëshkimit fizik (rrahjes) që i pret.

> Mashkull, 14 vjeç:
> *"Kur bëj gabime më bërtasin. Kam frikë të shkoj në shtëpi. Kur bëj gabime, si psh. kur zihem, mami më thotë që kur është me nerva të mos shkoj në shtëpi."*

Gjithashtu, vlen të theksojmë se një pjesë thanë që prindërit nuk përdorin ndonjë teknikë disiplinuese kur fëmijët bëjnë gabime duke i toleruar ose duke qenë tërësisht indiferent ndaj tyre. Ndërkohë, shembulli i mëposhtëm tregon një mënyrë agresive që një prej fëmijëve të intervistuar përdor për të modeluar sjelljen e prindërve duke imituar shprehje që prindërit përdorin me të.

> Mashkull, 14 vjeç,
> *"Prindërit i rrahin fëmijët kur bëjnë gabime. Babi dhe mami s'më prekin me dorë... Ajo (mami) ka frikë nga unë. I kam thënë. Ik. Moj thyefsh qafën."*

Nga ana tjetër, pyetjes se kush janë personat që ofrojnë më shumë mbështetje, fëmijët raportuan më shpesh nënat, vëllezërit dhe motrat më të mëdhenj, shokët dhe gjyshërit.

Në përgjithësi vendimet për fëmijët i merr nëna ose babai (në më të shumtën e rasteve nënat). Shpesh fëmijët tregojnë se prindërit i informojnë ata për vendimet, përveç rasteve kur ata konsiderohen të vegjël në moshë. Gjithashtu, pyeten më shumë vajzat dhe djemtë më të mëdhenj në familje.

Shpesh herë edhe marrëdhëniet midis vëllezërve dhe motrave rezultojnë të jenë të dhunshme. Disa prej fëmijëve treguan se zihen shpesh me vëllezërit dhe motrat për t'u pajtuar më pas. Ndërkohë në dy raste, fëmijët treguan se vëllezërit më të mëdhenj e përdorin dhunën fizike për t'i detyruar ata që të lypin apo të punojnë. Kur diferenca moshore midis vëllezërve dhe motrave është e madhe, fëmijët treguan se marrëdhëniet ishin më të largëta.

Pjesa më e madhe e fëmijëve raportojnë marrëdhënie të mira midis prindërve. Gjithsesi në tre raste fëmijët pohuan se shpesh prindërit zihen për gjëra që kanë lidhje me marrëdhënien mes tyre. Në njërin prej rasteve, fëmija pohon dhunë ushtruar nga babai ndaj nënës së fëmijës. Ndërkohë në një rast tjetër, fëmija tregon se konfliktet midis prindërve shkaktoheshin nga fakti që babai pinte alkool. Këto probleme që çojnë në funksionimin e keq të familjes sjellin shqetësime emocionale te fëmijët, ndjenja ankthi, pasigurie, mungese

kontrolli, pasiguri për prindin viktimë si dhe konfuzion. Sipas citimit të mëposhtëm, fëmija në fillim të intervistës shfaqi hezitim për të përshkruar natyrën e vërtetë të marrëdhënieve midis prindërve, por më vonë ai përshkroi përjetime të forta trishtimi për çfarë ka ndodhur në familjen e tij.

Mashkull, 10 vjeç:
"Mami dhe babi duhen, hanë dhe kalojnë kohë bashkë. Babi që kur e ka marrë, s'e ka prekur me dorë…Herën e fundit babi e rrahu mamin dhe ajo iku. Ne nuk dinim ku ta kërkonim, patëm frikë. Ai i ra me dërrasë te këmba dhe mami theu këmbën. Unë u mërzita shumë. "

ç) Aktivitetet dhe rutina ditore të fëmijës

Aktivitet ditore të fëmijëve të intervistuar përfshijnë të punuarit apo të lypurit, aktivitetet në qendër, lojërat me shokët dhe shoqet, kohën e kaluar në shkollë, punët për pastrimin e shtëpisë, shëtitje në rrugët e qytetit me kushërinj apo shokë, shikim programesh në televizor dhe rrallëherë lexim librash. Në përgjithësi fëmijët shprehen se gjatë ditës nuk kryejnë shumë aktivitete të larmishme dhe se çdo ditë bëjnë të njëjtat aktivitete. Shumica e fëmijëve ankohen se nuk ka shumë mundësi ose lojëra dhe aktivitete në komunitetin e tyre për të kryer aktivitete gjatë kohës që ata nuk punojnë apo nuk shkojnë në shkollë dhe në qendër. Ndërkohë që evidentojnë se në qendrat që frekuentojnë, loja është një nga aktivitetet më të dashura dhe që u pëlqen shumë.

4.3. Përvoja e lëvizjes së fëmijëve

a) Arsyet e lëvizjes, destinacionet dhe kohëzgjatja e qëndrimit

Vendet e mbërritjes përtej kufijve më së shpeshti janë Kosova, Greqia dhe Italia. Për fëmijët që lëvizin për të punuar apo jetuar bashkë me familjet e tyre brenda kufijve të Shqipërisë, vendet e mbërritjes janë kryesisht Tirana, Durrësi dhe Saranda, gjatë periudhës së verës. Gjithsesi në disa raste fëmijët kanë treguar se kanë patur histori të komplikuara lëvizjesh që mund të përfshijnë ato jashtë vendit edhe ndër qytete të ndryshme të Shqipërisë. Arsyet e lëvizjes variojnë në varësi të nevojave të familjes. Arsyet kryesore rezultojnë të jenë: a) vështirësitë ekonomike në familje, b) mungesa e mundësive për punë për prindërit dhe fëmijët në vendet e origjinës, c) mundësia të siguruar të ardhura në vendet e mbërritjes që do t'i ndihmonin familjet të lanin borxhet shpejt, ç) mundësi për një edukim më të mirë dhe shërbime më të mira shëndetësore në vendet e mbërritjes, si dhe më rrallë d) konflikte në lidhje me pronësinë e shtëpisë.

Koha e qëndrimit varion nga disa muaj në disa vite. Për fëmijët që kanë lëvizur nga Shqipëria në Greqi dhe anasjelltas, më së shumti koha e qëndrimit është e gjatë. Këta fëmijë ose kanë lindur në Greqi ose kanë shkuar atje shumë të vegjël. Pas një qëndrimi të gjatë familjet kanë vendosur për arsye të caktuara të zhvendosen për në Shqipëri apo në Kosovë.

Mashkull, 14 vjeç:
"Në Greqi kemi qenë 7 vjet. Erdhëm dhe pastaj shkuam në Kosovë për 3 vjet. Dhe tani erdha prapë në Shqipëri. "

Për fëmijët që lëvizin drejt Kosovës, udhëtimet janë të shpeshta dhe për periudha afatshkurtra. Fëmijët e këtij grupi tregojnë se kanë qënë në Kosovë nga një muaj deri në 3 vjet. Arsyet kryesore të lëvizjes drejt Kosovës janë për të lypur apo punuar në sera dhe

grumbullim hekurash.

Ndërkohë lëvizjet brenda vendit kanë kohëzgjatje të ndryshme në varësi të arsyes së lëvizjes. Targeti i fëmijëve që lëvizin për të punuar në qytete të tjera, lëvizin kryesisht për periudha të shkurtra disa ditore ose mujore. Ky është rasti i fëmijëve që lëvizin nga Fieri drejt Tiranës apo fëmijëve që shkojnë për të punuar në Sarandë ose Durrës.

Mashkull, 15 vjeç:

"Unë jetoj në Fier. Kam qenë në Tiranë 3 herë këtë vit. Shoqëroja vëllain dhe nipin kur lypnin. "

Nga ana tjetër një grup i dytë fëmijësh lëvizin nga zonat rurale në zona peri-urbane të qyteteve të Durrësit dhe Tiranës për të ndërtuar një jetesë më të mirë së bashku me familjet e tyre. Dy fëmijët e intervistuar në zonën e Kënetës dhe katër të tjerë të intervistuar në zonën e Bathores treguan se prindërit e tyre kishin vendosur të jetonin në një qytet me mundësi më të mira punësimi për ta dhe edukim apo shërbim shëndetësor më të mirë për fëmijët e tyre.

Të gjithë fëmijët pjesëmarrës në këtë studim raportuan se në vendin e mbërritjes janë gjithmonë të afërm apo të njohur që i presin. Ata zakonisht sigurojnë banesën dhe ndonjëherë edhe vendet e punës për prindërit dhe fëmijët. Pjesa më e madhe e të afërmve bëjnë të njëjtat lloje punësh si ato që do të përfshihen prindërit dhe fëmijët pas mbërritjes.

Pothuaj të gjithë fëmijët raportojnë se gjatë qëndrimit në vendin e mbërritjes kanë qënë të shoqëruar nga prindërit, motrat dhe vëllezërit e tyre. Vetëm në dy raste, fëmijët kanë jetuar me gjyshërit dhe të afërm të tjerë në vendet e mbërritjes. Po ashtu, përveç një rasti gjatë udhëtimit fëmijët kanë qënë të shoqëruar gjithmonë nga prindërit apo vëllezërit dhe motrat.

Më së shumti, udhëtimi është realizuar me mjete të transportit publik si autobuze, furgon, traget apo avion. Në disa raste të veçanta, fëmijët kanë udhëtuar me mjete private të prindërve apo familjarëve të tjerë. Përvec fëmijëve që kishin lëvizur kur kishin qenë të vegjël në moshë të cilët nuk e mbanin mend mirë përvojën e lëvizjes, fëmijët e tjerë treguan se ishin ndier mirë dhe të sigurtë gjatë udhëtimit.

Në lidhje me pyetjet mbi udhëtimin, shumica e fëmijëve përgjigjen se udhëtimi ka qënë i mirë pasi kanë patur mundësi të shihnin vende të reja. Gjithsesi për një numër të vogël fëmijësh, udhëtimi është perceptuar si i gjatë dhe "pak i frikshëm" për shkak të rrugëve të këqia dhe lëkundjeve të mjeteve të transportit. Është e rëndësishme të shtojmë se disa fëmijë kanë qenë shumë të vegjël gjatë lëvizjes së parë dhe rrjedhimisht e kishin të vështirë të rikujtonin përvojën e udhëtimit.

c) Vendimmarrja për lëvizjen e fëmijëve

Pothuaj në të gjitha intervistat u pohua se vendimin për lëvizjen e fëmijëve e kishin marrë prindërit, ndonjëherë vetëm baballarët ose vetëm nënat dhe rrallëherë të dy bashkë. Vetëm dy fëmijë treguan se ishin ata që sugjeruan apo vendosën. Këta të fundit pohuan se prindërit i kanë pyetur nëse do t'u pëlqente të lëviznin drejt vendeve të caktuara duke u dhënë atyre një informacion të përmbledhur mbi vendin e mbërritjes. Në rastet e tjera, pasi prindërit kishin marrë vendimin ua kishin komunikuar atë fëmijëve në momentin e fundit para se të largoheshin. Vetëm disa fëmijë treguan se ishin pyetur nga prindërit mbi çfarë mendonin dhe a ishin dakort me lëvizjen. Në përgjithësi, fëmijët kishin pranuar pa diskutuar shumë mbi këtë çështje, përveç rasteve kur ata ishin shumë të lidhur me vendin e origjinës. Komunikimin e vendimit për të lëvizur më së shumti e bëjnë nënat. Gjithsesi nga intervistat rezulton se të pakta janë rastet që fëmijëve iu tregohet mbi jetën në vendin e mbërritjes.

Femër, 12 vjeç:
"Erdhi babi me makinë dhe më mori për të lypur në Athinë. Vetëm motra më tha se ku do shkoja dhe çfarë do bëja atje. Unë nuk e dija. Babi vendosi vetë dhe nuk më pyeti. "

ç) Pasojat e lëvizjes

Nga përgjigjet e dhëna, vihet re se procesi i lëvizjes shpesh shoqërohet me ndjenja të forta keqardhjeje dhe mërzi që shkaktohen prej largimit nga vende, kultura dhe njerëz të njohur dhe të dashur. Kështu fëmijët tregojnë se kanë mall për shokët që kanë lënë në vendet e origjinës, për natyrën dhe strukturën e qyteteve të mëparshme, për kulturën dhe gjuhën e vendeve ku ndodheshin. Disa fëmijë shprehen se për shkak të largimit ata u shkëputën nga shkolla dhe kjo gjë i shqetëson. Gjithashtu, disa fëmijë që kanë ardhur në Shqipëri pas shumë vitesh jetese në Greqi, raportojnë se dobësim të mirëqënies ekonomike të familjes pas ardhjes nga Greqia, për shkak të mundësive të pakta të punësimit për prindërit. Nga ana tjetër, fëmijët që lëvizin shpesh për të punuar në Kosovë, shprehen se mundësitë që shfaqen në Kosovë për fitime nga lypja dhe puna në të zezë janë më të mëdha se në Shqipëri.

Përsa i përket grupit të fëmijëve që lëvizin brenda Shqipërisë për të punuar, intervistat tregojnë se shpeshherë në vendet e mbërritjes fëmijët përballen me situata të vështira ekonomike. Dy djem të cilët udhëtojnë nga Fieri për të lypur në mënyrë sezonale në Tiranë, treguan se flinin në parqet e qytetit ose në shtëpitë e njerëzve të panjohur. E njëjta gjë raportohet nga një vajzë e cila kishte lëvizur disa herë me familjen për të lypur në Sarandë. Ajo na tregon se disa herë familjes së saj i është dashur të jetojë në bodrume pa dritare dhe pa dyer.

Fëmijë të tjerë që kanë lëvizur me familjet e tyre për të jetuar në periferitë e Durrësit dhe të Tiranës tregojnë se gjatë lëvizjes kanë ndjerë mall për vendin e mbetur pas, trishtim për lidhjet e humbura dhe pasiguri për vendin e mbërritjes. Nga ana tjetër, ata raportuan gjithashtu kënaqësi dhe kuriozitet për vendin dhe kulturën e re.

Djalë, 12 vjeç:
"Këtu shoqëria është më e mirë, njerëzit më të afrueshëm. Në fillim më erdhi keq që ikëm nga fshati se aty ishte vendlindja ime, por tani u mësova. Tani pas 4 vjetësh ndihem shumë mirë. "

Ndërkohë që disa prej fëmijëve shprehen se lëvizja nuk ndryshoi gjë në jetën e tyre përveç rritjes së të ardhurave të familjes, një pjesë e madhe e tyre tregojnë se udhëtimet u kanë shërbyer shumë për përftimin e aftësive të reja. Ndër këto aftësitë të reja ata tregojnë: a) mësimi i një gjuhe të huaj ose dialekti të ri, b) aftësi teknike si rregullim biçikletash, motorrash, prerje drush apo vjelje perimesh në sera, c) aftësi socializuese përmes krijimit të miqësive me fëmijë të etnive të tjera, d) aftësi orientuese në lëvizjen në mënyrë të pavarur në vende të panjohura për ta më parë, si dhe e) aftësi artistike si kërcim

Për fëmijët banorë të zonës së Kënetës dhe Bathores, jeta ka ndryshuar në disa aspekte. Fëmijët treguan se udhëtimi i përditshëm për në shkollë është më i shkurtër dhe më i sigurtë se në vendet e origjinës. Po ashtu ata raportuan se mjedisi ku jetojnë është i ndryshëm nga i mëparëshmi duke e lidhur këtë me kulturën e vendit të ri, mungesën e të afërmëve dhe praninë e komshinjve të rinj në vendet e mbërritjes.

Femër, 12 vjeç:
"Këtu është edhe më mirë, edhe më keq. Këtu ka zhurmë makinash, ajër i papastër... këtu kam mësuar anglisht. Tani jam më e rritur, kam mësuar të bëj edhe ndonjë gatim në shtëpi. Jeta ime ka ndryshuar që tani shkoj në shkollë më herët. "

Kur u pyetën në lidhje me shqetësime të mundshme që fëmijët mund të kenë aktualisht, një pjesë e vogël e fëmijëve raportuan se nuk kishin shqetësime. Gjithsesi një pjesë e konsiderueshme e tyre shfaqën një ndjenjë pasigurie të vazhdueshme për jetën, të nesërmen, për sigurinë dhe mirëqënien e tyre kur treguan se kishin shqetësime të vazhdueshme si: a) mungesa e parave në shtëpi, b) pamundësia për të vazhduar shkollën, c) mungesa e veshjeve dhe ushqimi më i mirë, ç) probleme shëndetësore të mëdha të vetes apo të prindërve të tyre, f) pasiguria nga konfliktet në komunitet, g) të bërtiturat dhe ndëshkimet fizike nga prindërit, vëllezërit dhe shokët, si dhe h) të tallurit dhe të vënit në lojë nga shokët në vendet e mbërritjes.

Disa prej fëmijëve shpjeguan se kur shqetësohen apo mërziten për arsyet e sipërpërmendura ata kanë reagime të formave të ndryshme si psh: a) tendencë për të qëndruar vetëm dhe për të mos folur me askënd, b) tendencë për tu përfshirë në grindje dhe konflikte me shokët, prindërit apo vëllezërit dhe motrat, c) tendencë për të shfryrë duke përplasur objektet në shtëpi apo zhgarravitur librat shkollorë, si dhe ç) të qara dhe ankesa ndaj prindërve dhe të afërmve të tjerë. Disa prej fëmijëve treguan gjithashtu se kur mërziten luajnë, dalin nëpër qytet ose dëgjojnë muzikë në shtëpi.

4.4. Shërbimet

a) Shkolla

Fëmijët e intervistuar tregojnë se ata përfitojnë shërbime të ofruara nga institucione të ndryshme si shërbime shëndetësore, ato arsimore dhe shoqata të ndryshme.

Për sa i përket frekuentimit të shkollës, një pjesë e mirë e fëmijëve treguan se kanë ndjekur disa muaj, një ose dy vite shkollore. Si rrjedhojë, shumë fëmijë nuk dinë të shkruajnë dhe të lexojnë. Vetëm një prej fëmijëve të intervistuar ka bërë tetë klasë shkollë. Disa prej fëmijëve tregojnë se e pëlqenin shkollën dhe se kishin patur rezultate të mira në shkollë për aq kohë sa e vazhduan atë. Gjithashtu një pjesë e fëmijëve tregon se gjatë frekuentimit të shkollës nuk bënin mungesa të shpeshta.

Bazuar në përgjigjet e fëmijëve, braktisja e shkollës tek pjesa më e madhe e tyre është rezultat i lëvizjes nga një vend në tjetrin. Arsye të tjera që fëmijët raportojnë janë a) vështirësitë ekonomike në familje që i shtyjnë fëmijët të punojnë, b) detyrimi për tu kujdesur për motrat dhe vëllezërit më të vegjël, c) pakënaqëitë për shkollën për shkak të sjelljes jo të mirë të mësuesve dhe fëmijëve të tjerë, e) vështirësi për të mësuar dhe ecur sit ë tjerët me mësimet apo d) pakënaqësi të përgjithshme për shkollën;

Kur u pyetën në lidhje me perceptimet dhe ndjenjat e tyre rreth shkollës, fëmijët u shprehen në dy forma të ndryshme:

Grupi i parë i fëmijëve shfaqte emocione pozitive në lidhje me shkollën, duke argumentuar se shkolla iu ofron mundësi të bëjnë aktivitete që s'i bëjnë dot në shtëpi si dhe të harrojnë problemet familjare. Në përgjithësi ky grup fëmijësh tregoi se ka patur raporte të mira me shokët dhe mësuesit në shkollë. Disa mendojnë se shokët dhe mësuesit i donin dhe silleshin mirë me ta pasi ata ishin të urtë dhe kishin sjellje të mirë në shkollë. Për sa i përket mësuesve, fëmijët argumentuan se mësuesit silleshin ashpër vetëm kur fëmijët bënin zhurmë dhe kjo ndoshta mund të ndikojë që ndër fëmijët e këtij target grupi pranueshmëria e dhunës nga mësuesit të jetë relativisht e lartë dhe të quhet si një reagim normal. Grupi i dytë i fëmijëve

përjetojnë emocione negative kur mendojnë për shkollën. Kjo pjesërisht e argumentuar në lidhje me përvojat me mësues të dhunshëm dhe mungesa e shokëve. Megjithatë, asnjë nga këta fëmijë nuk tregoi episode dhune (fizike) nga shokët e shkollës apo mësuesit. Disa prej fëmijëve të këtij grupi ndjejnë keqardhje që e kanë braktisur atë. Më tej, dy fëmijë treguan se frustrimin e tyre per shkollën e shprehin përmes zhgarravitjes së librave.

Fëmijë, I14:
"Unë shkoja në shkollë, po bëja mungesa. Kam bërë tre klasë, por e lashë. Mësuesja ishte e keqe dhe më bërtiste. Unë merrja 10 në shkollë. E lashë shkollën se më mërziste mësuesja. Shokët e klasës ishin të mirë."

Femër, 14 vjeç:
"Kur mendoj për shkollën, mendoj se ka njerëz që bërtasin".

b) Shërbimet shëndetësore

Për sa i përket shërbimeve shëndetësore, pjesa më e madhe e fëmijëve tregojnë se ata apo pjesëtarë të tjerë të familjes kanë shkuar te doktori vetëm kur kanë qënë shumë të sëmurë, pa bërë paraprakisht kontrolle mjekësore parandaluese. Gjithashtu, një numër i vogël i fëmijëve të intervistuar tregojnë se dhe pse nuk kanë qënë asnjëherë te mjeku, kanë mundur të shkojnë te infermierja e fshatit apo një farmacist i cili i ka vizituar dhe këshilluar mjekimin.

Shumë prej fëmijëve nuk raportuan probleme të theksuara shëndeti përveç gripit apo ftohjes. Vetëm një prej fëmijëve të intervistuar ka një gjendje delikate shëndetësore e cila është edhe arsyeja kryesore e lëvizjes së tij për t'u kuruar çdo vit jashtë shtetit. Nga ana tjetër disa fëmijë treguan se kishin qenë në urgjencë apo spital për probleme më të mëdha si djegie me zjarr dhe aksident me makinë (e përplasi makina) gjatë lypjes, helmim nga ushqimi për shkak të mungesës së frigoriferit në shtëpi, etj.

Një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve shprehen se nuk kanë informacion për shërbime shëndetësore në vendin e mbërritjes. Kjo është edhe më e dukshme te fëmijët që lëvizin për kohë të shkurtër, të cilët treguan se vizitat mjekësore i kanë bërë gjithmonë në vendin e tyre të origjinës (Tirana, Fieri, Korça ose Shkodra). Nga përgjigjet e dhëna u konstatua se fëmijët Romë që lëvizin për të punuar, vizitoheshin shumë rrallë kur ata ishin shumë të sëmurë.

Mashkull, 14 vjec:
"Shkoj te doktori, vetëm kur jam shumë sëmurë".

Ata fëmijë që treguan raste të vizitave mjekësore të kohëve të fundit, u shprehën se gjatë vizitës mjekët i kanë trajtuar "mirë". Gjithsesi, ata treguan se në shumë pak raste mjekët u kanë folur atyre drejtpërsëdrejti apo i kanë informuar rreth gjendjes së tyre shëndetësore dhe mjekimit të ofruar. Komunikimi më së shumti ndodh mes mjekut dhe prindit i cili ka çuar fëmijën për vizitë.

Përsa i përket fëmijëve të ardhur në zonën e Bathores dhe Kënetës, fëmijët raportuan se janë vizituar disa herë në qendrat shëndetësore në komunitetet e reja dhe kanë qenë të kënaqur me shërbimin e marrë.

Sipas bisedës me fëmijët, kur shkojnë te mjekët në Shqipëri, prindërit e tyre duhet të

paguajnë të paktën 2000 lekë të reja për shërbimin mjekësor. Po ashtu, ata tregojnë se harxhojnë shumë para për kryerjen e analizave dhe marrjen e mjekimit kështu që ndodh shpesh që nuk arrijnë t'i bëjnë gjithë analizat apo marrin gjithë ilacet. Dy fëmijë treguan se për shkak se mjekimi kushtonte shumë, prindërit nuk kishin mundur t'i blinin ilaçet.

Është e rëndësishme të theksohet se nga intervistat e fëmijëve nuk u konstatuan raste ku mjekët janë sjellë keq apo shfaqën mungesë etike gjatë ofrimit të shërbimit. Gjithsesi kjo gjetje duhet parë dhe në këndvështrimin e perceptimeve të një grupi fëmijësh të margjinalizuar të cilët mund të jenë tashmë të përshtatur me reagime të caktuara dhe mund ta kenë të vështirë të bëjnë dallimin mes çfarë është etike apo jo në marrjen e shërbimit.

c) Shërbimet e përkujdesit të ofruara nga organizatat

Pothuajse të gjithë fëmijët treguan se ata dhe prindërit e tyre marrin shërbime nga shoqatat (si ngrënia e një vakti, bërja e detyrave të shtëpisë, marrja e ilaçeve falas dhe marrja pjesë në aktivitetet verore ose ekskursione në rrethe të tjera). Shpeshherë, ata e perceptojnë shërbimin e ofruar nga shoqata në bazë të ndihmës që marrin prej punonjësve të saj sesa prej institucionit në vetvete. Ky është një tregues i cili thekson rëndësinë që ka për një fëmijë marrëdhënia individuale dhe e drejtpërdrejtë me ofruesin e shërbimit. Kur flasim për "shërbime", shërbimet e para që u vinin në mendje fëmijëve të intervistuar lidhen me ndihmën në nivel të mirash materiale duke e konkretizuar si: ofrim ilaçesh, ushqime, pako dhe mjete shkollore. Gjithsesi ata shtojnë edhe aspekte të tjera të rëndësishme si lojërat me shokët dhe shoqet apo aktivitetet e ndryshme si kampet verore, shëtitjet dhe pikniqet brenda dhe jashtë qyteteve të tyre, etj.

Ata mësuan për ekzistencën e shoqatës nga shokët e komunitetit, nëna, të afërm, nga monitoruesja (punonjëse e Ëorld Vision) ose nga një shoqatë tjetër. Aktualisht, fëmijët e intervistuar kanë akses dhe frekuentojnë aktivitetet në këto shoqata: "Arsis", "Terre des Hommes", "FBSH", "Selvia", "Shoqata Sot Për Të Ardhmen", "World Vision", qendra "Besa", një shoqatë pranë Stacionit të Trenit, në Tiranë dhe ndonjë shoqatë tjetër që nuk ia dinë emrin (rasti i shoqatës në Korçë që ka referuar një fëmijë të intervistuar te qendra "Arsis").

4.5. Puna e fëmijëve

Dy të tretat e fëmijëve që intervistuam punojnë si në vendet e origjinës ashtu dhe në ato të mbërritjes. Format e punës ndryshon në varësi të aktivitetit. Fitimet dhe mundësitë për punë variojnë sipas vendeve ku fëmijët shkojnë. Pjesa më e madhe e fëmijëve të intervistuar treguan se lypin. Të tjerët mbledhin hekura dhe kanaçe, rregullojnë biçikleta, ndihmojnë nënat të qepin këpucë ose kontrollojnë në kazanët e plehrave. Këta fëmijë, gjatë lëvizjes së tyre për në vende të tjera si Kosovë dhe Greqi, apo qytete si Tiranë dhe Sarandë kanë ndryshuar llojin e punës, p.sh. nga rregullim biçikletash ose mbledhje hekurash në lypje.

Pjesa më e madhe e tyre punojnë së bashku me prindërit ose vëllezërit dhe motrat më të mëdhenj. Disa fëmijë tregojnë se janë prindërit dhe vëllezërit që u kërkojnë të punojnë. Pjesa më e madhe e fëmijëve shprehen se ndihen të sigurtë kur punojnë së bashku me familjet e tyre. Gjithsesi disa prej tyre treguan se kur lypnin në Tiranë, flinin në lulishte ose kishin patur incidente si shtypje me makinë, djegie nga zjarri gjatë lypjes në rrugë apo të qënit dëshmitarë kur dikush tjetër që lypte është shtypur në rrugë.

Sipas fëmijëve, ata që lypin fitojnë mesatarisht 1000 lekë të reja në ditë. Pjesën më të madhe të parave ua dorëzojnë prindërve dhe një pjesë fare të vogël e përdorin për internet a bilardo. Fëmijët që lëvizin për të punuar në Kosovë treguan se veçanërisht në Kosovë fitimet nga lypja dhe puna janë shumë më të larta se në Shqipëri apo Greqi. Dy fëmijë nga zona e Bathores treguan se qepin këpucë në shtëpi dhe fitojnë afërsisht 300 lekë për palë. Këtë shumë ata ua dorëzojnë nënave të tyre, duke marrë parasysh vështirësitë e tyre ekonomike.

Ndryshe nga fëmijët e tjerë që punojnë, këta dy fëmijë e konsideronin punën e tyre si ndihmë ndaj familjes dhe jo si punë në vetvete.

> Mashkull, 15 vjeç:
> *"Ndonjëherë fitoj 1000 lekë në ditë, herë të tjera fitoj 2000 mijë. Ia jap lekët vëllait. Ai më rreh dhe i merr. Ai rreh ndonjëherë dhe mamin. Edhe mami pi alkol".*

Së fundmi, shtatë prej fëmijëve të intervistuar (mbi 10 vjeç) pohuan se nuk punonin në rrugë ose nuk lypnin. Këta janë fëmijë që kanë filluar të shkojnë në shkollë dhe të ndihmojnë prindërit në punët e shtëpisë ose të merren me rritjen e vëllezërve dhe motrave.

4.6. Siguria në komunitet

Kur u pyetën në lidhje me sigurinë në lagje, shumica e fëmijëve u shprehën fillimisht se në rrugë ndihen të sigurtë, pasi nuk ka rreziqe ose gjëra që mund t'i frikësojnë. Më tej, gjatë intervistave, disa prej fëmijëve Romë treguan se kanë patur incidente me "njerëz me thika", me fëmijë më të mëdhenj që janë përpjekur tu vjedhin kanaçet, të alkolizuar agresiv në rrugë dhe qenë që i kanë frikësuar. Katër fëmijë të tjerë të posa ardhur në qytet, pohuan se nuk janë shumë të sigurtë pasi s'i njohin rrugët. Ata treguan se ndonjëherë, prindërit i shoqërojnë në shkollë ose gjatë shëtitjeve në lagje.

Disa prej fëmijëve treguan se kanë besim te policët dhe do të ndiheshin të mbrojtur nga ata në rast rreziku. Ata që shfaqën frikë nga policët druhen se ata mund t'u bërtasin ose gjuajnë duke qënë së janë të armatosur.

4.7. Burimet e frikës

Disa prej fëmijëve të intervistuar treguan se kanë frikë nga sulme apo agresione në rrugë (p.sh. kanë frikë se fëmijët e tjerë mund t'i vjedhin). Ndërkohë fëmijët raportuan edhe frikëra me natyrë tjetër si: frikë nga merimangat, nga gjarpërinjtë, nga ëndrrat e këqija dhe hijet. Një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve të intervistuar, nuk treguan objekte frike.

4.8. Koncepti i fëmijëve mbi lumturinë

Koncepti mbi lumturinë varion midis fëmijëve të intervistuar. Disa fëmijë e lidhin lumturinë më së shumti me të qënit dhe të shkuarit mirë në shkollë, harmoninë në familje, marrëdhënie të mira me prindërit, shëndet të mirë dhe virtyte të mira. P.sh. një fëmijë thotë se e dallon një fëmijë të lumtur kur ai duket mirë, i qeshur dhe sillet mirë me të tjerët. Ndërsa një tjetër thotë se po të kishte shokë do të ishte i lumtur. Kjo gjetje konfirmohet edhe nga përgjigjet në lidhje me pyetjen nëse fëmijët janë aktualisht të lumtur. Shumica e atyre fëmijëve që treguan për marrëdhënie të mira midis prindërve dhe vëllezërve e motrave u përgjigjen po. Ata vetë argumentuan se pavarësisht se ata lypnin, punonin dhe jetonin në kushte të këqija, për ta ishte e rëndësishme që familja e tyre ishte e bashkuar.

Femër, 16 vjeç.
"Fëmijë i lumtur është ai që del me familjen e tij".
(Fillon dhe qan).

Ndërkohë, përvec marrëdhënieve familjare dhe shoqërore, një grup tjetër fëmijësh e lidhën lumturinë më së shumti me zotërimin e të mirave materiale, jetesën në një shtëpi të mirë, të paturit ushqim, veshje dhe lodra të mira. P.sh., një prej tyre thotë se fëmijë i lumtur është ai që ka shtëpi dhe se ai do të ishte më i lumtur po t'i kishte këto.

4.9. Vizioni për të ardhmen

Shumica e fëmijëve mendojnë se në të ardhmen do të jetojnë në një shtet tjetër (Itali, Greqi ose Angli). Disa e lidhin të ardhmen me punën që do të bëjnë. Kështu, fëmijët Romë që lëvizin për punë dëshirojnë që në të ardhmen të vazhdojnë të bëjnë të njëjtën punë si tani si lypje apo rregullim biçikletash. Nga ana tjetër, fëmijët e tjerë dëshironin të studionin brenda ose jashtë dhe zgjidhnin profesione si doktorë apo avokatë. Disa prej fëmijëve Romë shtuan se në vizionin e tyre ishte edhe plani për t'u martuar dhe "bërë" shumë lekë për familjen. Në grupin e fëmijëve të ardhur në Bathore, ne vumë re se në vizionin e tyre për të ardhmen një rol të rëndësishëm luajnë modelet pozitive, p.sh. nëse kanë të afërm që emigrojnë në Itali ose Angli, ku studjojnë dhe punojnë.

4.10. Përshtypjet për intervistën

Shumë prej fëmijëve u ndjenë mirë ose shumë mirë gjatë intervistës. Megjithatë dy prej tyre u mërzitën. Ndërsa njëri u shpreh se u lodh nga pyetjet, tjetri tregoi se pyetjet i rikujtuan probleme personale dhe për rrjedhojë pati një shpërthim emocional në fund të intervistës. Dy fëmijë e ndërprenë intervistën sepse për arsye të ndryshme duhet të largoheshin nga vendi i intervistimit.

5. DISKUTIME

Ky vlerësim kishte për qëllim eksplorimin e përvojave të lëvizjes së fëmijëve brenda dhe jashtë vendit, mënyrën se si vetë fëmijët e përjetojnë atë si dhe aspekte të tjera të jetesës së tyre. Studiueset ndoqën një metodologji cilësore të mbledhjes së të dhënave. Njëzet intervista të thelluara individuale u realizuan me fëmijë 8-15 vjeç. Fëmijët pjesëmarrës ishin fëmijë që lëvizin në mënyrë të shoqëruar ose jo, brenda dhe jashtë vendit. Ata u kontaktuan pranë qendrave dhe organizatave që ata frekuentojnë dhe ku ata marrin shërbime. Fëmijët e intervistuar banojnë aktualisht në rrethet Tiranë, Durrës dhe Fier.

Gjetjet kryesore ofrojnë një panoramë të gjerë të aspekteve të ndryshme të procesit të lëvizjes së fëmijëve. Duke e konsideruar përvojën e lëvizjes si një proces zinxhir të përcaktuar nga hapa të njëpasnjëshëm, gjetjet u grupuan sipas këtyre hapave: arsyet e lëvizjes, lëvizja (zhvendosja, udhëtimi dhe vendosja në vendin e ri), procesi i përshtatjes në vendndodhjen e re si dhe pasojat e lëvizjes në jetën e fëmijëve.

Grupi i fëmijëve të intervistuar u përzgjodh qëllimisht që të ishte heterogjen në mënyrë që të eksploroheshin dinamikat e lëvizjes së fëmijëve që vinin nga situata të ndryshme familjare apo kishin përvoja të ndryshme lëvizjeje (jashtë dhe brenda vendit). Gjithsesi, duke u bazuar në kriteret e nevojave të fëmijëve, fëmijët e intervistuar mund të ndahen në dy grupe:

Grupi i parë është i përbërë nga fëmijë të cilët vijnë nga familje me vështirësi të mëdha ekonomike, me prindër kryesisht të papunë ose që fitojnë të ardhura përmes lypjes, grumbullimit të kanaçeve, hekurave dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Këto familje mbështeten te të ardhurat e mbledhura nga lëvizjet e shpeshta për punë brenda dhe jashtë vendit. Ata kryesisht vijnë nga komuniteti Rom dhe lëvizja e tyre shpesh planifikohet me qëllim që të sigurohen nevojat bazike jo vetëm të fëmijëve por edhe të familjes siç janë nevojat për ushqim dhe veshmbathje. Këta fëmijë kanë nevoja të mëdha pasi jetojnë në kushte shumë të këqija, kanë përvoja pune në të zezë ashtu si prindërit e tyre dhe gjithashtu shpeshherë kanë probleme marrëdhëniesh në familjet e tyre të mbipopulluara.

Grupi i dytë i fëmijëve të intervistuar është i përbërë nga fëmijë që vijnë nga familje, gjendja ekonomike e të cilëve varion nga niveli pranë varfërisë në atë të një gjendje mesatare ose të mirë ekonomike. Lëvizja e tyre është vendimtare që do të thotë, fëmijët kanë lëvizur bashkë me familjet për të jetuar një kohë të gjatë në vendin e mbërritjes. Natyra e nevojave të këtyre fëmijëve është disi e ndryshme nga ato të grupit të parë. Këta fëmijë, kanë të paktën një prind të vetëpunësuar ose emigrant, jetojnë në kushte mesatare ose të mira banimi, por ndonjë prej tyre raporton probleme marrëdhëniesh në familje, përvoja të të punuarit në shtëpi (qepje këpucësh), gjendje shëndetësore të dobët ashtu si dhe probleme gjatë procesit të përshtatjes pas lëvizjes. Gjithashtu është e rëndësishme të thuhet që në krahasim me grupin e parë, nevojat e këtij grupi janë më të variueshme nga një rast në tjetrin.

Duke bërë këtë ndryshim midis dy grupeve të fëmijëve, ne nuk duam të lëmë pa konsideruar karakteristikat specifike të lëvizjes së çdo fëmije të cilat mund të jenë të ndryshme nga njëri fëmijë në tjetrin dhe ndikohen nga personaliteti dhe situata familjare e çdo fëmije. Në të vërtetë, nxjerrja e përfundimeve përgjithësuese në lidhje me lëvizjen e fëmijëve që u përkasin kategorive të ndryshme social-ekonomike në Shqipëri, e tejkalon qëllimin e studimit dhe metodologjisë së ndjekur.

5.1. Arsyet e lëvizjes

Të dhënat e grumbulluara në këtë studim në lidhje me motivet e lëvizjes së fëmijëve janë në linjë me disa nga përfundimet e studimeve të mëparshme rreth lëvizjes së fëmijëve në botë apo trafikimit dhe migrimit të pashoqëruar të fëmijëve në Shqipëri. Kështu, gjetjet e studimit tonë tregojnë se arsyet e lëvizjes për fëmijët e grupit të parë janë vështirësitë e mëdha ekonomike në familje, mungesa e mundësive për punësim për prindërit dhe fëmijët në vendet e origjinës si dhe joshja e të fituarit më shumë para dhe në një kohë të shkurtër në vendet e mbërritjes. Këta fëmijë lëvizin drejt destinacioneve jashtë vendit ose drejt qytetit të Tiranës dhe Sarandës për të punuar në mënyrë sezonale. Ndëkohë grupi i dytë i fëmijëve që jetojnë në kushte ekonomike pak më të mira, kanë lëvizur në vendet e ardhjes për një mundësi edukimi dhe akses më të mirë në shërbimet shëndetësore. Ata janë vendosur kryesisht në rrethinat e formuara pas viteve '90 në qytetet Tiranë dhe Durrës.

Në të dyja grupet duket se përgjithësisht janë prindërit që vendosin për këtë lëvizje duke u mjaftuar me një komunikim të vendimit te fëmijët. Gjithsesi, fëmijët e grupit të parë, ndryshe nga fëmijët e lagjeve peri-urbane nënkuptojnë në përgjigjet e tyre një rol më aktiv gjatë proçesit të lëvizjes. Ata e shohin veten si pjesëtarë të familjes që kanë detyrimin ashtu si edhe prindërit apo të rriturit e tjerë të lëvizin për të siguruar të ardhura për të gjithë familjen. Nga ana tjetër, në familjet e grupit të dytë, fëmijët duket se e shohin veten më shumë si pasues të vendimeve dhe planifikimeve të realizuara më parë nga prindërit.

5.2. Lëvizja (zhvendosja, udhëtimi dhe vendosja në vendin e ri)

Lëvizja e të gjithë fëmijëve të intervistuar rezulton të ketë qenë pothuaj në të gjitha rastet e shoqëruar prej prindërve. Kjo ndihmon që fëmijët të ndihen të mbrojtur gjatë lëvizjes po ashtu edhe përshtatjes me vendin dhe kulturën e re. Në lidhje me këtë, ne pamë se fëmijët e grupit të parë të cilët kanë nevoja më bazike, punojnë gjithmonë pranë pjesëtarëve të tyre të familjes. Po ashtu, në rastin e fëmijëve të Bathores apo Kënetës, lëvizjet brenda zonës së re realizohen gjithmonë bashkë me prindërit. Kjo e fundit, mund të jetë edhe një tregues i pasigurisë që fëmijët mund të ndjejnë në vendndodhjet e tyre të reja.

Lëvizja e fëmijëve përbrenda dhe jashtë vendit bëhet si me mjete publike po ashtu edhe private. Në lidhje me lëvizjet ndërkombëtare, fëmijët nuk raportuan lëvizje migratore të paligjshme. Në disa prej intervistave, ata raportuan se edhe përpara liberalizimit të vizave, prindërve u duhet të mblidhnin para apo të merrnin borxh për të paguar vizat dhe rrugën.

Një pikë e përbashkët që del nga të gjitha intervistat e realizuara lidhet me praninë e të afërmve që jetojnë paraprakisht në vendin e mbërritjes së fëmijëve dhe që lehtësojnë jo vetëm proçesin e lëvizjes por sigurojnë edhe një rrjet dhe suport të mirë social për fëmijët dhe familjet e tyre në të ardhmen. Kohëqendrimi i fëmijëve në vendet e ardhjes varion në varësi të qëllimit të lëvizjes. Kështu, për fëmijët e grupit të parë që vijnë nga familje të varfëra ekonomikisht dhe që lëvizin kryesisht për të përmirësuar financat e familjes, lëvizjet janë të shpeshta, shpesh të kombinuara brenda dhe jashtë vendit. Për një pjesë të mirë të këtyre fëmijëve, kohëqendrimi është disa javë ose muaj. Kjo mund të sjellë pasoja shumë të mëdha në jetën e fëmijëve dhe veçanërisht në përshtatjen dhe ri-përshtatjen e tyre në vendet ku lëvizin.

5.3. Proçesi i përshtatjes

Në të vërtetë, të dhënat rreth përshtatjes së fëmijëve me vendet e reja drejt të cilave kanë lëvizur, flasin për një proçes të ndërlikuar dhe të influencuar nga shumë faktorë, si familjarë, individualë apo karakteristikat e komuniteteve të reja. Proçesi i përshtatjes përfshin emocionet dhe mendimet e fëmijëve gjatë largimit nga vendi i origjinës si dhe gjatë përballjes me një mjedis dhe kulturë të re.

Kështu, lëvizja te këta fëmijë shpesh shoqërohet me ndjenja ambivalente. Fëmijët raportuan ndjenja mërzie për shkëputjen nga shokët, të afërmit dhe jeta e mëparshme, si dhe pasiguri për vendin e ri. Por nga ana tjetër ata gjithashtu raportuan edhe entuziazëm për mundësitë më të mëdha për zhvillim individual apo familjar që mund të ofrohen në vendndodhjet e reja.

Në vazhdimësi, vërejmë një ndryshim lehtësisht të dukshëm në cilësinë e jetës së tyre. Për fëmijët që vijnë nga familje shumë të varfëra, mbas ndryshimit të vendbanimit, disa prej tyre kanë një përmirësim të lehtë të të ardhurave. Duke qenë se mundësitë për punësim janë disi më të larta, ata ushqehen dhe vishen më mirë si dhe mund të kenë disa kursime për të jetuar më vonë pas kthimit në vendin e origjinës. Shumë fëmijë mësojnë aftësi të reja si një gjuhë të re (p.sh. greqishten ose dialektin kosovar), aftësi teknike të përfituara nga punë të reja, mënyra më të sofistikuara të të sjellurit si dhe zhvillojnë aftësi të mira socializuese dhe pavarësi/autonomi duke lëvizur në një vend të ri. Nga ana tjetër, lëvizjet në këtë target-grup shoqërohen me shkëputje nga shkolla, mundësi më të rralla për vizita mjekësore në vendet e reja, po ashtu edhe situata ku fëmijët mund të rrezikojnë shfrytëzim për punë nga të afërm apo aksidente gjatë punës.

Për fëmijët që vijnë nga familje me nevoja më pak urgjente, ndryshimi i cilësisë së jetës rezulton të jetë pozitiv. Ai i atribuohet faktit që shkollat dhe qendrat shëndetësore për fëmijët dhe pjesëtarë të tjerë të familjes janë më afër se më parë. Duke ndjekur modelet teorike të përballjes me situatat e reja dhe të panjohura, po ashtu edhe përshtatjen me vendet e reja ndër fëmijët emigrant, të dhënat e mbledhura informojnë për disa përfundime të rëndësishme.

Ashtu sic përshkruhet nga Shenoy në lidhje me përshtatjen psikologjike dhe social-kulturore të fëmijëve emigrant me vendin e ri (1996), përshtatja e fëmijëve të intervistuar gjithashtu mund të ndikohet nga disa faktorë siç janë: koha e qëndrimit, ndryshimi i vlerave dhe normave kulturore midis vendit të origjinës dhe vendndodhjes së re, mbështetja sociale e marrë nga familja apo pjesëtarë të tjerë të komunitetit si dhe mekanizmat individualë të menaxhimit të situatave të reja.

Ne vërejmë se fëmijët që lëvizin për periudha më të gjata shprehnin më shumë njohuri mbi vendin e mbërritjes, njohje të gjuhës, po ashtu edhe më shumë siguri në vendin ku ata punonin, luanin apo lëviznin. Gjithashtu në këto raste, përshkrimet e fëmijëve mbi vendet e reja janë më të pasura dhe më të gjalla. Më tej, për fëmijët që qëndrojnë për kohë relativisht të gjata, numri i shokëve të bërë në vendet e ardhjes është edhe më i madh.

Ndër burimet më të fuqishme të përshtatjes me kulturën e re të raportuara nga fëmijët është të paturit shokë apo të afërm bashkëmoshatarë në vendet e ardhjes. Në rastet e fëmijëve që kanë lëvizur bashkë me familjet e tyre për të jetuar në Kënetë dhe Bathore, apo kanë lëvizur në drejtim të Tiranës për të punuar, burime mbështetje janë edhe shkollat dhe qendrat që ata frekuentojnë. Ata aty vihen në kontakt me bashkëmoshatarë por gjithashtu edhe me vlera të shprehura dhe të nënkuptuara të komuniteteve të reja.

Ndryshimi kulturor është një element më tepër i përmendur nga fëmijët pjesëtarë të familjeve që janë zhvendosur drejt zonave të Kënetës dhe Bathores. Për fëmijët e kësaj kategorie, dendësia e popullsisë në zonat e ardhjes si dhe indiferenca që ekziston rreth komshinjve të rinj në vendbanimet e tyre është burim stresi dhe pakënaqësie. Për të tejkaluar këto vështirësi, këta fëmijë mbështeten te fqinjët dhe të afërm që i njohin që para lëvizjes.

Në rastet e fëmijëve të grupit të parë, ekspozimi në vendbanimet e reja është më i madh dhe më pak i kontrolluar nga familjarët. Këta fëmijë punojnë dhe kalojnë një kohë shumë të gjatë jashtë shtëpisë me bashkëmoshatarët e tyre. Kjo mund të ndihmojë që ata të përfitojnë më shpejt disa aftësi praktike për të zgjidhur situata të reja dhe të panjohura në vendin e mbërritjes.

Më tej përshtatja e fëmijëve në vendndodhjet e reja mund të jetë e ndikuar edhe nga njohuria që fëmijët marrin nga prindërit për qëllimin dhe kohëzgjatjen e lëvizjes si dhe karakteristikat e vendndodhjes së re. Kështu, mund të supozojmë se kur lëvizja kryhet për kohë të shkurtra dhe të shpeshta, mund të mos jetë prioritet për këta fëmijë përshtatja me kulturën e vendndodhjeve të reja.

5.4. Pasojat dhe efektet e lëvizjes në jetën e fëmijëve

Shumica e fëmijëve të intervistuar lëvizin së bashku me familjen. Sipas informacionit që fëmijët dhanë, mendojmë se përvec rreziqeve, lëvizja u ofron atyre edhe shumë mundësi për zhvillim.

Gjatë lëvizjes, fëmijët pohojnë se kanë përvetësuar aftësi të reja që mund t'i shërbejnë në të ardhmen. Grupi i fëmijëve Romë ka fituar aftësi në komunikimin në gjuhën greke dhe dialektin kosovar, aftësi teknike si rregullim biçikletash, motorrash, prerje drush apo vjelje perimesh në sera, aftësi socializuese me fëmijë të etnive të tjera, aftësi artistike si kërcim dhe pavarësi. Grupi tjetër ka përfituar njohuri duke ndjekur shkolla më të mira, dhe koncepte të reja jetese duke jetuar tashmë në zona peri-urbane.

Edhe pse lëvizja shkakton një përmirësim të gjendjes së tyre ekonomike (tek të dy grupet), ky përmirësim është shumë i lehtë dhe nuk përbën një ndryshim rrënjësor apo "bum" ekonomik. Nga ana tjetër, ndonjëherë ndodh që lëvizja e përmirëson sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës. Kështu pjesa e fëmijëve të intervistuar që lëvizin nga zonat rurale në periferi të Tiranës ose në Durrës pohojnë se në vendet e mbërritjes kanë akses për shërbime shëndetësore më të mira si dhe mundësi arsimimi më të mira.

Duhet të theksohet se asnjë nga grupet e fëmijëve nuk raportoi raste abuzimi, keqtrajtimi apo prostitucioni. Kjo ndoshta edhe për faktin se për të shprehur abuzim është e nevojshme për fëmijët të krijohet një marrdhënie më e sigurtë dhe e besueshme me intervistuesi, gjë që nuk mund të realizohej në kuadrin e një interviste të vetme.

Ndërkohë lëvizja e fëmijëve të intervistuar ka patur edhe shumë pasoja negative. Kështu, për sa i përket shfrytëzimit për punë, ky është një koncept i panjohur nga fëmijët. Fëmijët në disavantazh të madh ekonomik kanë bërë punë si rregullim biçikletash, lypje etj., për të ndihmuar familjet në vështirësi ekonomike. Këtë gjë ata nuk e përjetojnë si shfrytëzim por si detyrim individual dhe pjesë normale të kontributit dhe rolit të tyre në familje. Edhe pse largohen nga shtëpia për pasur një aktivitet ekonomik, shpesh herë ato ndodhen në kushte të vështira pune dhe me pagesë të ulët (kryesisht grupi i fëmijëve Romë). Shpesh ata jetojnë në kushte shumë të vështira jetese (p.sh. flenë në lulishte, ose në një dhomë që e kanë marrë me qera dhe e kanë të vështirë ta paguajnë).

Grupi i fëmijëve Romë për shkak të lëvizjes nga një vend në tjetrin, detyrohen të braktisin shkollat dhe të mos kenë informacion mbi shërbimet shëndetësore në vendet e mbërritjes. Për shkak të statusit të emigrantit (ose sepse nuk bëjnë përpjekje në këtë drejtim), fëmijët nuk mund të gëzojnë në mënyrë të plotë të drejtat e tyre për të pasur akses në shërbimet shëndetësore, arsimore dhe mbrojtëse dhe hasin pengesa. Nuk e dimë sa të ndërgjegjshëm janë ata për këtë diskriminim. Barriera si nevoja për të punuar, pamundësia për të mësuar gjuhën (fëmijë Romë që kanë emigruar jashtë vendit në Greqi apo Itali), pengojnë frekuentimin e shkollës në vendin e mbërritjes. Ka nga ata që që duhet të kujdesen

për vëllezërit dhe motrat ose u mërzitet shkolla pasi mësuesit sillen keq. Të tjerë fëmijë nuk dinë të shpjegojnë arsyet e kësaj braktisjeje.

Nga ana tjetër, në komunitetin e ri, fëmijët duhet të përshtaten me një stil të ri jete, kulturë dhe gjuhë. Shpeshherë, përshtatja me vendndodhjen e re mund të jetë e dhimbshme dhe të sjellë pasoja në gjendjen e tyre emocionale si izolim dhe braktisje të shkollës.

Së fundmi është e rëndësishme të theksohet se ndërkohë që lëvizja duket se influencon në vizionin që fëmijët mund të kenë në të ardhmen, kjo lidhje nuk shfaqet qartë përsa i përket konceptit të lumturisë. Koncepti i fëmijëve mbi lumturinë është shumë i lidhur me natyrën e marrëdhënieve familjare dhe shoqërore me bashkëmoshatarët si dhe cilësinë e jetesës në familjet, kjo e fundit e konkretizuar me të mira materiale, ushqim dhe veshmbathje. Duke qënë se lëvizja shpesh realizohet me prindërit, motrat dhe vëllezërit, kjo mund të ndikojë në forcimin e marrëdhënieve gjatë periudhave të vështira. Po në këtë linjë, lëvizja shpesh i siguron familjes të ardhura më të mira, dhe për rrjedhim mund të kontribuojë në kënaqësinë dhe lumturinë e fëmijëve. Gjithsesi është e rëndësishme të theksohet se lëvizja e shkëput fëmijën nga marrëdhënie të tjera të rëndësishme si marrëdhënia me miqtë në lagje apo shkollë, të cilat shihen gjithashtu si pjesë e rëndësishme e lumturisë. Gjithashtu lumturia te këta fëmijë mund të ndikohet nga shumë elementë të tjerë stresantë ose jo, të lidhur me lëvizjen dhe përshtatjen, të cilët nuk janë identifikuar në këtë studim për arsye të ndryshme. Një nga këto arsye mund të jetë pasi për këtë target grup fëmijësh mund të jetë shumë e vështirë reflektimi dhe artikulimi mbi ndjenjat. Gjithashtu pyetjet në lidhje me këtë temë, u realizuan në fund të intervistës e cila ishte mjaftueshëm e gjatë. Një eksplorim më i qëllimshëm mbi këtë aspekt në studime të tjera, mund të hidhte dritë mbi marrëdhënien që ekziston midis përvojës së lëvizjes dhe ndjenjës së lumturisë te këta fëmijë.

5.5. Kufizimet dhe pikat e forta të vlerësimit

Metodologjia e përdorur në këtë studimi përmban disa kufizime të cilat influencojnë intepretimin e gjetjeve dhe formulimin e rekomandimeve. Duke përdorur një metodologji cilësore dhe për rrjedhojë një kampion të vogël të përzgjedhur qëllimisht, përfundimet e këtij studimi nuk mund të përgjithësohen për të gjitha rastet e fëmijëve që lëvizin brenda dhe jashtë Shqipërisë. Studimi në vetvete tregoi se natyra e lëvizjes dhe proçesi i përshtatjes në vendndodhjet e reja janë të larmishme dhe ndikohet nga shumë faktorë. Por, nga ana tjetër, studimi ofron një të kuptuar të mirë të tendencave të lëvizjes së fëmijëve, jep të dhëna të mira për motivet, rrugët dhe pasojat e lëvizjes të cilat mund të eksplorohen apo konfirmohen më tej në studime më të thelluara cilësore dhe sasiore.

Më tej është e rëndësishme të përmendim se përzgjedhja e fëmijëve përmes shoqatave dhe institucioneve që ata frekuentojnë kufizojnë gjetjet e studimit. Kjo pasi, një pjesë e gjetjeve të lidhura me përshtatjen në vendndodhjet e reja mund t'iu atribuohen edhe ndihmës dhe shërbimeve të marra nga shërbimet e ofruara përmes shoqatave si dhe lehtësimit të marrdhënies mes ofruesve tëshërbimeve dhe fëmijëve e familjeve të tyre.

Një kufizim tjetër në metodologjinë e ndjekur lidhet me proçedurat e intervistave. Duke synuar që informacioni i mbledhur të ishte sa më i detajuar mbi përvojën e lëvizjes por gjithashtu duke ndjekur edhe ritmin dhe drejtimin që fëmijët i jepnin bisedës, intervistat ndonjëherë ishin më të gjata sesa koha e planifikuar. Kjo mund të ketë shkaktuar lodhje te disa fëmijë, gjë që mund të ketë ndikuar edhe në përgjigjet e dhëna. Për t'i mbajtur fëmijët të përqendruar gjatë intervistës në kalimet nga një grup pyetjesh në tjetrën, ne përdorëm disa shprehje për t'i inkurajuar dhe vlerësuar fëmijët për kontributin e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, gjatë bisedave ndonjëherë ishte e nevojshme të bëheshin pushime të shkurtra në rastet kur fëmijët raportonin shqetësime të lidhura me pyetje të vecanta.

Një kufizim tjetër është përdorimi i pakët i gjuhës shqipe te disa prej fëmijëve Romë. Te këta fëmijë të cilët banojnë në fshatin Drizë në Fier, intervistat u realizuan me ndërmjetësimin e një përkthyesi. Edhe pse përkthyesi kishte njohuri të mira të të dy gjuhëve dhe ishte një njeri i besueshëm për fëmijët në komunitet, prania e tij mund të ketë ndikuar në përgjigjet e fëmijëve.

Së fundmi është e rëndësishme të theksojmë se të dhënat e mbledhura në këtë studim janë të bazuara në perceptimet dhe këndvështrimet e fëmijëve dhe mund të mos shprehin të vertëtat për jetën e fëmijëve. Gjithashtu një aspekt tjetër që mund të ketë ndikuar në përgjigjet e dhëna janë aftësitë komunikuese të fëmijëve të cilat ndryshojnë në varësi të moshës dhe zhvillimit intelektual e social të fëmijëve. Psh., fëmijët më të vegjël shpesh i përshkruanin ndjenjat dhe mendimet e tyre me një gjuhë me të thjeshtë e konkrete sesa fëmijët më të rritur.

6. REKOMANDIME

Duke u bazuar te gjetjet e studimit, pikat e forta dhe kufizimet e metodologjisë së ndjekur ne formuluam disa rekomandime të cilat janë për diskutim

Së pari, ashtu siç përmendim edhe më sipër, duke bazuar mbi gjetjet e vlefshme të këtij studimi por gjithashtu edhe kufizimet e metodologjisë së ndjekur, ne rekomandojmë për të ardhmen, studime me pjesëmarrje më të madhe të fëmijëve nga grupe të përcaktuara qartë në varësi të llojit të lëvizjes apo nevojave të fëmijëve. Këto studime do të ofronin një bazë më të mirë të dhënash për të formuluar rekomandime më koncize operacionale për aktorët kyç që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Së dyti, duke parë pasojat dhe përfitimet që fëmijët kanë nga lëvizja përtej dhe brenda kufijve të Shqipërisë, ne rekomandojmë ndarjen e gjetjeve dhe rekomandimeve të përmbledhura në këtë raport me institucionet dhe aktorët kyç. Kjo do të ndihmonte jo vetëm në zgjerimin dhe konsolidimin e njohurive mbi këtë çështje por do të fuqizonte edhe aktorët në bashkërendimin e punës së tyre për të siguruar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve të këtij grupi fëmijësh pavarësisht nga territori gjeografik.

Së treti, për të të rritur efektivitetin e ndërhyrjeve lehtësuese mbi pasojat e lëvizes së fëmijëve, do të rekomandonim futjen e kësaj çështjeje në axhendën e bashkëpunimeve në rang rajonal kombëtar dhe ndërkombëtar përsa i përket mbrojtjes së fëmijëve. Këto bashkëpunime mund të ndihmojnë jo vetëm për mbështetjen e veprimtarive ndërgjegjësuese, por edhe identifikimin e fëmijëve që lëvizin, ndarjen e informacionit midis aktorëve që operojnë në vendet e origjinës dhe ato të mbërritjes si dhe adresimin e nevojave te tyre për mbrojtje dhe shërbime të tjera.

Së katërti, të diskutohet me aktorët kyç (Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Shërbimin Social Shtetëror, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, organizatat që punojnë me këtë grup fëmijësh dhe me cështjet e të drejtave të fëmijëve), në nivel kombëtar, sesi sistemi i mbrojtjes dhe përkujdesit të fëmijëve të mund të identifikojë dhe adresojë nevojat e fëmijëve në lëvizje, të evidentojë protokollet dhe mënyrat e ndihmës në mënyrë që fëmijët në lëvizje si brenda dhe jashtë Shqipërisë të jenë lehtësisht të identifikueshëm dhe mundësisht shërbimet të ofrohen pa u kushtëzuar nga aspekti gjeografik.

Së pesti, një paketë trajnimesh mund të informojë punonjësit që kanë kontakt me fëmijët në lëvizje në lidhje me mënyrat e identifikimit dhe punës që duhet bërë me këtë grup fëmijësh dhe familjet e tyre. Këta aktorë kyç përfshijnë punonjës të NjMF-ve, psikologë të shkollave, punonjës socialë pranë qendrave dhe OJQ-ve, policë në kufi, mjekë, infermierë apo mësuesit.

Së gjashti, është e rëndësishme që ofruesit e shërbimeve të paisen me shprehi komunikimi dhe të punohet me aspektet e mos diskriminimit, barazisë dhe cilësisë në ofrimin e shërbimeve për këtë grup fëmijësh dhe familjesh.

Së shtati, ashtu sic dhe fëmijët janë shprehur nëpër intervista, frekuentimi i aktiviteteve të ndryshme sociale, argëtuese dhe edukuese nëpër qendra apo organizata i ka ndihmuar ata për të zhvilluar shoqëri, miqësi dhe të pëlqejnë këto aktivitete. Do ishte me vlerë nëse nëpër këto aktivitete të integroheshin aktivitete që u mësojnë fëmijëve aftësitë mbrojtëse, aftësitë sociale dhe zhvillojnë më tej mirëqënien e tyre psikosociale.

Së fundi, puna më konkrete e drejtpërdrejtë me fëmijët dhe familjet e tyre mund të përfshijë disa aspekte, duke filluar nga parandalimi, ndërhyrjet e hershme si dhe mbështetje në situatë rreziku për fëmijët. Të tjera aspekte të punës me familjen duhet të përfshijnë sugjerimet e mëposhtme të tilla si:

- Identifikimin e vazhdueshëm të familjeve dhë fëmijëve që janë të predispozuar për të lëvizur shpesh dhe referimi pranë ofruesve të shërbimeve.
- Identifikimin dhe lehtësimin e faktorëve ekonomikë dhe socialë që mund të motivojnë familjet të marrin vendime për lëvizje nga vendet e origjinës,
- Punë me prindërit për të lehtësuar situatën e varfërisë duke kërkuar punë dhe duke e mos u e konsideruar më punën e fëmijëve si një burim mbështetje për familjen.
- Punë me fëmijët për zhvillimin e aftësive përshtatëse, mbrojtëse, rritjen e aftësive të reziliencës, gjë që mund t'i ndihmojë ata në përballjen psikologjike me realitetet e reja, Punë me fëmijët, shkollat dhe qendrat shëndetësore për të lehtësuar proçesin e ri integrimit të fëmijëve që lëvizin pranë këtyre institucioneve.
- Punë me fëmijët dhe familjet për të lehtësuar proçedurat e tërheqjes apo njehsimit të dokumentave nga vendi i origjines në vendin e mbërritjes.
- Identifikimin dhe adresimin e aspekteve të dhunës në familje, dhunës ndaj fëmijëve duke marrë parasysh se lëvizja ndikon në rritjen e vulnerabilitetit të këtyre fëmijëve.
- Puna me programet e informimit dhe parandalimit nga ana e ofruesve të shërbimeve si mësuesit, personeli mjekësor për të qenë më të vëmendshëm, të hapur, të komunikueshëm me këtë grup fëmijësh. Këtu mund dhe të nxiten edhe bashkëpunimet ndër rajonale me vendet ku shkojnë këto familje për të shkëmbyer informacionet, dhe ofrimin e shërbimeve.
- Vetë fëmijët mund të përfshihen dhe të jenë pjesëmarrës për të referuar fëmijë të tjerë pranë shërbimeve si dhe për t'u përfshirë në programe informimi dhe edukimi për bashkëmoshatarët e tyre.

7. REFERENCA

Boland, K. (2010). *Children on the move: A report on children of Afghan origin moving to western countries.* UNICEF.

Danaj, S. (2008). *Raport i analizës së situatës së trafikimit të fëmijëve në Shqipëri.* BKTF.

IOM. (2007). Profili i Migracionit. Republika e Shqipërisë: Ministria e Brendshme e Republikës së Sllovenisë, Ljubljana.

Kasimati, M., Kolpeja, V., & Hatibi, D. (2009). *Migracioni shqiptar pas viteve 90-të dhe ndikimi i tij në jetën ekonomike dhe sociale të fëmijëve të lënë pas.* UNICEF, Instituti për Kërkime Urbane.

Lazarus, R. S., & Folkman, S. (1984). *Stress, appraisal, and coping*. New York: Springer.

Orgocka, A. & Jasini, A. (2007). Assesment in child trafficking vis a vis smuggling in the Northwest of Albania. Partnerë për Fëmijët.

Orgocka, A (2010). The international migration of children from rural North East Albania. In J. Kanics, D. S. Hernandez and K. Touzenis (Eds), *Migrating Alone: Unaccompanied and separated children's migration to Europe* (pp.129-142). Unesco Publishing.

Reale, D. (2008). *Away from home: Protecting and supporting children on the move*. Save the Children.

Rossi, A. (2008). *The impact of migration on children developping countries.* Harvard University Kennedy School of Government.

Scherer, K. R. (2001). *Appraisal* considered as a process of multi-level sequential *checking*. In K. R. Scherer, A. Schorr, & T. Johnstone (Eds), *Appraisal processes in emotion: Theory, Methods, Research* (pp. 92-120). New York and Oxford: Oxford University Press.

UNICEF. (2011). *Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri.*

Yaqub, S. (2009). *Independent child migrants in developing countries: Unexplored links in migration and development*. Innocenti Working Paper, UNICEF, Florence.

Weiten, W. & Lloyd, M.A. (2008) *Psychology applied to modern life (9th ed.)*. Wadsworth Cengage Learning.

8. ANEKS

Aktorë të rëndësishëm që punojnë me fëmijët në lëvizje

Disa nga aktorët më të rëndësishëm që adresojnë çështje të fëmijëve në lëvizje qoftë në planin e hartimit të politikave ashtu edhe në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes përfshijnë institucionet qendrore dhe vendore si Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Pushteti Lokal, po ashtu edhe organizatat jo-qeveritare ndërkombëtare dhe lokale. Lista e mëposhtme nuk është ezauruese. Ndër organizatat kryesore që kanë në qendër të punës së tyre mbrojtjen dhe adresimin e nevojave të kësaj kategorie fëmijësh janë:

- **ALO 116 / CRCA** – Linja e telefonit për fëmijë ofron shërbim kwshillimi 24 orë përmes marrjes së telefonatave për shqetësime të fëmijëve nga i gjithë territori i Shqipërisë.
- **ARSIS** (është një organizatë joqeveritare, e specializuar në përkrahjen sociale të të rinjve që janë në vështirësi ose në rrezik, gjithashtu dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Target- grupi i ndërhyrjes se ARSIS ne Tiranë janë fëmijët e rrugës, viktima të trafikut e të shfrytëzimit dhe familjet e tyre të cilët janë shpeshherë të përfshirë në lëvizje brenda dhe jashtë vendit, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin. ARSIS ofron ndihmë ligjore (pajisje me certifikata dhe dokumenta), ndihmë mjekësore, (pajisje me libreza shëndetësore) mbështetje psikosociale për fëmijët dhe nënat e tyre, mbështetje shkollore si dhe një vakt. Qendra e emergjencës është e hapur 72 orë për fëmijët në gjendje krize.)
- **BKTF** (Koalicioni Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve) operon në Shqipëri që në shkurt të vitit 2003 dhe përbëhet nga 28 organizata kombëtare dhe ndërkombëtare. BKTF advokon dhe lobon në mbrojtje të fëmijëve shqiptarë nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, dhe trafikimit. BKTF lobon për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri bazuar në interesin më të lartë të fëmijës dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.
- **FBSH-DN** (Fëmijët e Botës dhe Shqipërisë – të Drejtat e Njeriut është një shoqatë jo-qeveritare që operon në Shqipëri që prej themelimit të saj në vitin 2002. Qëllimi i organizatës është të mbrojë fëmijët në risk duke u bazuar në një qasje holistike përmes fuqizimit të fëmijëve dhe familjeve të tyre për ti ri-integruar ata në shkollë. Kjo organizatë punon më së shumti me fëmijët Romë dhe Egjiptianë të cilët janë shpesh të ekspozuar ndaj përvojave të ndryshme të lëvizjes.)
- **IOM** (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin) punon veçanërisht mbi trafikimin e fëmijëve dhe migracionin e fëmijëve të pashoqëruar: Një sërë programesh dhe aktivitetesh janë realizuar me qëllim ndërtimin e kapaciteteve dhe ndihmën për fëmijët dhe familjet e tyre dhe parandalimi i komuniteteve që ndodhen në një shkallë të lartë rreziku.
- NPF (Ndihmë për Fëmijët është një organizatë lokale jo-qeveritare e cila ka për qëllim mbështetjen e fëmijëve të margjinalizuar, familjeve të tyre dhe komuniteteve ku ata jetojnë. Përmes projekteve të ndryshme edukuese, kjo organizatë ofron ndihmë dhe mbështetje për fëmijët e përfshirë në lëvizje për të parandaluar rrezikun e trafikimit të tyre.)
- **SHKEJ** (Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën është një shoqatë lokale jo-qeveritare e cila ushtron aktivitetin e saj në Tiranë në favor të te miturve dhe familjeve te tyre në vështirësi. Përmes projekteve të tyre ata ofrojnë shërbime sociale dhe edukuese në tre qendra ditore. Target-grupi i punës së tyre është fëmijët e rrugës dhe fëmijë të tjerë të margjinalizuar të cilët mund të kenë përvoja lëvizjeje.)
- **Save the Children** nëpërmjet një programi rajonal për Përgjigje ndaj Trafikimit të Fëmijëve është fokusuar në aspektin e parandalimit, mbrojtjes dhe integrimit të fëmijëve

në rrezik dhe projektit te Qendrës Ditore për Fëmijët që Jetojnë e Punojnë në Rrugë në partneritet me Bashkinë e Tiranës ku synohet të sigurohet mbështetje dhe shërbime mbrojtëse për fëmijët dhe të rinjtë që jetojnë e punojnë në rrugë.

- **Terre des homes**, përmes programit të "Ndërtimit dhe Forcimit të Rrjetit të Sigurt për Mbrojtjen e Fëmijëve" punon në fushën e parandalimit, ngritjes së kapaciteteve dhe advokimit për të forcuar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri në partneritet me organizata të tjera dhe me institucionet shtetërore.
- **ISS** (Shërbimi Social Ndërkombëtar-Dega Shqipëri është një organizatë jo-qeveritare ndërkombëtare e angazhuar që të ndihmojë individë dhe familje që kanë probleme personale ose sociale si rezultat i migracionit dhe lëvizjeve ndërkombëtare).
- Shoqata "Shpresë për të Ardhmen", Forumi për Integrimin Social, Kulturor dhe Ekonomik, Shoqata e Grave Profesioniste dhe Afariste, Tauleda (Unioni i Progresit Rajonal Durrës), të kordinuara nga IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin) kanë formuar një rrjet organizatash për të bashkërenduar veprime në projekte të përbashkëta që lidhen me emigracionin.
- **UNHCR** (bashkëpunon me qeverinë për të mbrojtur dhe ndihmuar azil-kërkuesit dhe refugjatët. Ky bashkëpunim nënkupton monitorimin e proçedurave për përcaktimin e statusit të refugjatit që kryhet nga qeveria, gjetjen e zgjidhjeve afatgjata për personat e përcaktuar si refugjatët dhe akomodimin e përkohshëm të tyre, kryesisht në Qendrën Kombëtare të Pritjes).
- **UNICEF** (mbështet institucionet e qeverisë dhe ato të shoqërisë civile për të ngritur strukturat e nevojshme për të përmbushur të drejtat e çdo fëmije me anë të politikave sociale, mbrojtjes ligjore dhe informacionit; për të siguruar zhvillimin dhe shëndetin e fëmijëve, mbrojtjen e tyre nga trafi kimi, abuzimi me substancë, dhuna dhe HIV/AIDS).
- **USAID Albania**: (Programe në lidhje me migracionin që mbështeten nga USAID).

Lista e kontakteve të NjMF-ve Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Njësia per Mbrojtjen e Fëmijeve			
Nr		Emri i punonjësit	Nr telefoni
1	Bashkia Durrës	Olta Bajraktari	695277034
2	Bashkia Fier	Alma Agalliu	692320724
3	Bashkia Vlorë	Jonida Dhroso	695667491
4	Bashkia Berat	Julinda Vokopola	694051095
5	Bashkia Kuçovë	Majlinda Serjani	694026041
6	Bashkia Gjirokastë	Marjanthi Bedjava	695799717
7	Bashkia Sarandë	Edlira Beqo	672111899
8	Bashkia Elbasan	Nadire Kreka	692295921
9	Bashkia Pogradec	Besa Xhani	692202996
10	Bashkia Korçë	Marjana Lara	692504959
11	Bashkia Shkodër	Rudina Kruja	674003128
12	Bashkia Peshkopi	Anjeza Vokaj	692910374
13	Bashkia Kukës	Morena Hoxha	24224141
14	Komuna Tomin, Dibër	Malinda Deshati	682447720
15	Komuna Zejmen, Lezhë	Violeta Paloka	683077034
16	Komuna Balldre, Lezhë	Emanuela Mirukaj	672511630
17	Komuna Dermenas, Fier	Fatos Koci	685585589
18	Komuna Novoselë, Vlorë	Ediola Doko	693922471
19	Komuna Qendër, Vlorë	Zamir Qezari	692339257
20	Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë	Marsida Ismailaja	683851888
21	Komuna Shirgjan, Elbasan	Filip Berdufi	672037033
22	Komuna Paperr, Elbasan	Eglantina Daka	683393392
23	Komuna Shushica, Elbasan	Etleva Mezini	684501090
24	Bashkia Bajram Curri	Elona Qelia	672034417
25	Komuna Milot, Kurbin	Malvina Kolaj	685565581